

Dukagjini "Nderi i Kombit"



Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XXI i botimit, nr. 240, Tetor 2023


Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër, Tel. +355685000229, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktore: Klodjana Serraj, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

Kur veshja këpucët e tua...

(Inteligenca emocionale)

Në kuadër të dashurisë për këtë gazetë, por edhe në një kohë kur të gjithë janë fiksuar për inteligjencën artificiale mendoj me vlerë thelbësore është inteligenca emocionale. U frymëzova për ta shkruar këtë artikull kur për shkak të rrugëtimit jetësor të 2 muajve të fundit fillova të lexoj librin më të njëjtin emër. Në dukje është thjesht si një fjalë shkencore, por është shumë më tepër se aq.

Edhe hyrjen e këtij artikulli e bëra jo për të tërhequr vëmendje sa për fenomenin e momentit që të gjithë e njohim. Por çfarë është inteligenca emocionale? Nëse marrim në nivel përkufizimi shkencor do të thotë 'Inteligenca emocionale (EI) i referohet aftësisë për të njohur, kontrolluar dhe vlerësuar emocionet', por do doja ta kaloja në nivel më personal shpjegimin: Në gjuhën e përditshme inteligjence emocionale do të thotë 'të hysh ose të veshësh këpucët e tjetrit'.



Fjala përshëndetëse e Dedë Prendaj në inaugurimin e lapidarit të T' lumnuemve

I nderuem Imzot Angelo Masafra, Ipeshkvi i Ipeshkvisë Shkodër-Pult, dhe meshtarë të pranishëm!

I nderuem kryetari i bashkisë Shkodër, z. Benet Beci

Familjarë të T' lumnuemve!

Të nderuem pjesëmarrës!

Jemi ketu sot, në zemër të Alpeve, në Dukagjinin tonë. Në kshytjellën e Krishtianizmit shqiptarë, në djepin e identitetit tonë kombëtar, në këtë ceremoni modeste të kujtojmë "Martirët e fesë dhe kombit Shqiptarë; të T' lumnuem prej Selisë së Shenjtë:

1. AT Ciprian Nika, OFM
2. At. Bernardin Palaj, OFM
3. At. Gjon Shllaku, OFM
4. At. Gasper Suma OFM
5. Dom Dedë Plani
6. Dom Lazer Shantoja
7. Gjelosh Lulashi martirë laik.

DUKAGJINI I KA PARLAMENTARËT E TIJ

Parlamenti i tretë Rural Shqiptar u mbajt me datat 11-13 tetor 2023 në mjediset e Universitetit Bujqësor të Tiranës

Një kuvend i rëndësishëm ku morën pjesë "parlamentarë nga i gjithë vendi" si përfaqësues të grupeve të ndryshme të zhvillimit në fshat, përfaqësues të disa ministrive dhe drejtorive të rëndësishme, përfaqësues të donatorëve dhe organizatave të ndryshme ndërkombëtare.

Tematika e Parlamentit të 3-të Rural Shqiptar - JETA BURON NGA FSHATI - përgatit terrenin për dialog dhe bashkëpunim konkret, për të analizuar realitetin dhe për t'u njohur më mirë me nevojat dhe problemet, për të reflektuar mbi vizionin dhe prioritetet si veprime kolektive me qëllimin final për të fuqizuar dhe përmirësuar cilësinë e jetës në komunitetet rurale në të gjithë vendin.

"Jeta buron nga fshati" shërben si një thirrje e fuqishme ...

NJË DJALË DUKAGJINI RREMBEN ÇMIM TEK "MIKROFONI I ARTE - VAÇE ZELA"

Sot me disa miq artiste ishim të ftuar në Festivalin "Mikrofoni i Artë - VAÇE ZELA", organizuar nga Shoqata KGV Lushnje, me kryetar z. Adriatik Gega dhe Bashkia Lushnje.

Një festival prefekt dhe mikpritje shumë bujare nga organizatorët...



Mbi globalizmin dhe imagjinatat e deformatuara antiglobaliste

- KRITIKE PËR LIBRIN- Globalizmi dhe përfytyrimet provinciale antiglobaliste

Shkruar nga FRAN GJOKA

Rreth librit: "Globalizmi dhe romantizmi antikapitalist" të "Mjeshtrit të Madh" Gëzim Tushi

Vijon me intensitet punën e vet studimore, hulumtuese e krijuese sociologu, Gëzim Tushi, si gjithnjë, të fokusuar në fushat e gjera të sociologjisë dhe problemeve sociale, të filozofisë, psikologjisë dhe shqetësimeve ekzistenciale, që ka sjellë koha postmoderne dhe në politologji. Gjithnjë autori me tendencë të qartë është i fokusuar në diagnostikimin e fenomeneve psikologjike, materiale dhe efektet sociale që ato reflektojnë ...

Kur veshja këpucët e tua...

(Inteligjenca emocionale)

Në kuadër të dashurisë për këtë gazetë, por edhe në një kohë kur të gjithë janë fiksuar për inteligjencën artificiale mendoj me vlerë thelbësore është inteligjenca emocionale. U frymëzova për ta shkruar këtë artikull kur për shkak të rrugëtimit jetësor të 2 muajve të fundit fillova të lexoj librin më të njëjtin emër. Në dukje është thjesht si një fjalë shkencore, por është shumë më tepër se aq.

Edhe hyrjen e këtij artikulli e bëra jo për të tërhequr vëmendje sa për fenomenin e momentit që të gjithë e njohim.

Por çfarë është inteligjenca emocionale?

Nëse marrim në nivel përkufizimi shkencor do të thotë 'Inteligjenca emocionale (EI) i referohet aftësisë për të njohur, kontrolluar dhe vlerësuar emocionet, por do doja ta kaloja në nivel më personal shpjegimin: Në gjuhën e përditshme inteligjenca emocionale do të thotë 'të hys ose të veshësh këpucët e tjetrit'.

A keni menduar ndonjëherë pse një person vepron në një mënyrë dhe jo në një tjetër? A keni menduar se pse një person thotë gjera të caktuara? Në një shoqëri si kjo e jona ku shprehja e emocioneve nuk është një nga pikat më të forta të veshësh këpucët e tjetrit mbetet një sfidë më vete. Do doja të ndalesha tek ajo që kam mësuar unë në këtë periudhë:

-Është vërtetuar se në kohët e lashta njerëzit besonin se, mendohej me zemër prandaj edhe ne shkrimet biblike shpesh here kur gjejmë fjalën zemër i referohet trurit, e duke u nisur nga kjo hapi i parë në këtë drejtim të jemi të vetëdijshëm për emocionet që ju sjelle secili veprim, secili person, secila ngjarje. Kjo ndodh, sepse kur jemi të vetëdijshëm dimë mirë si të

vlerësojmë marrëdhëniet me njerëzit, ke duam afër dhe ke jo, për cilat gjera reagojmë pozitivisht e me cilat jo. A e bëjmë këtë? Shume pak. Dhe 'fale' fakti që nuk e bëjmë këtë dalim tek pasojat e saj, vetmenaxhimi. Shpesh here kemi dëgjuar për njerëz që na rrethojnë 'ka gjakun e nxehtë', sidomos në anët tona ku për hir

nuk e kanë personale reagimin ashtu, e kanë me veten, me botën ku jetojnë me rrethanat. Ajo çfarë na mbetet ne, është të tregojmë se nuk është çdo gjë bardh e zi, por mrekullisht ka edhe nuanca tjera, mbase duke i veshur këpucët i shërojmë një zemër.


Në vazhdim të kësaj një nga vlerat më

shumica e njerëzve dëgjojnë vetëm për t'u përgjigjur dhe jo për të kuptuar. Të dëgjosh dikë për ta kuptuar do të thotë të jesh empatik, jemi pak por mund të jemi shumë më shumë. Duke qenë empatik na lejon gjithashtu të kuptoni dinamikën e fuqisë që shpesh ndikon në marrëdhëniet, në mjediset e vendit të punës. Kjo është e rëndësishme për të udhëhequr ndërveprimet tona me njerëz të ndryshëm që takoni çdo ditë.

Një nga pikat kyçe të inteligjencës së emocioneve është motivimi i brendshëm. Fatkeqësisht sot shohim çdo ditë e më shumë, që janë të prirë drejt shpërblimeve të jashtme si paraja, fama, njohja dhe vlerësimi. A e keni kuptuar një që kur e ndiqni diçka aq më shumë largohet si paraja për shembull?... Une personalisht kam kuptuar se, nëse e bën diçka thjesht, sepse të përmbush si njeri, të besh një veprimtari, ku qëllim primar është të arrish pikën kulmore të një çështje, të marrësh një iniciativë, të përkushtohesh, ndaj pasioni, paratë vijnë vetë, me besoni! Ose... keni parë që njerëzit jetojnë për rrjete sociale se kush bën pushime të bukura vendet më ekzotike? Gjithashtu flas personalisht, udhëtimin më të bukur të këtij viti e kam bërë në një fshat të Dukagjinit, në krahinën e Shalës pa qene kurrë i quajtur, Nica, e kam bërë në këmbë dhe nuk do ta ndërroja as me Balin e Indonezisë. (do përmendja edhe Thethin, por atë e njihni të gjithë).

Si përfundim i gjithë qëllimi është imagjinoni një botë kur në të arrinim të kuptonim një koleg, pse është i zëmëruar ose një mik që kemi përballë, pse është i trishtuar, sa e emancipuar do ishte...

KLODJANA SERRAJ



të së vërtetës jemi natyra impulsive. Duke e vlerësuar në dy anë këtë pjesë, një person që ka gjakun e nxehtë duhet të mendojmë pse reagoi ashtu, të provojmë me vesh këpucët e tij, mbase ka qenë e tepërt një ngjarje caktuar në jetën tij edhe për atë, mbase e ka gjetur të papritur dhe reagon ashtu sepse dikush tjetër ka reaguuar në të njëjtën mënyrë me te si ai me ty, sepse në shumicën e rasteve këta individë

të çmuara që ka një shoqëri e emancipuar, duke qenë edhe motoja e shoqatës tonë, janë aftësitë sociale. Me këtë nuk them të kemi shume miq, është mirë edhe ajo, por kur them aftësitë sociale çështja themelore është 'të dëgjuar aktiv'. A ju ka ndodhur që kur i thoni diçka dikujt, ju kthen një përgjigje krejt tjetër ose e lidh direkt me veten? Kjo ndodh, sepse kam vënë re, por qenka e vërtetuar edhe shkencërisht se,

NJOFTIM!

Në ora 10.00, date 30 shtator 2023, dite e shtune, takim me anëtarët e Këshillit të Ri të SHAD, në mjediset e Bar-Restorant "Casablanca", anëtarët e të cilit janë: Agron Hasanaj, Anton Kosteri, Arbër Shytani, Arbër Raja, Diana Bungu, Dukate Bregu, Motër Dukate Radoja, Edmond Tërthorja, Elida Delija, Fatmir Vojvoda, Getjan Gropaj, Gjon Fierza, Gjergj Leqejza, Klodiana Serraj, Kolë Çardaku, Kolë Sukullari, Ledia Dushi, Luigj Shyti, Leze Bungaja, Lazer Kodra, Martin Ahi, Mikel Kopsaj, Marjana Koçeku, Martin Arra, Ndue Vata, Niko Marku, Ndue Nika, Prele Milani, Roza Pjetri, Suela Ndoja, Tonin Marku, Viola Shqau, e Viktor Arrinaj e Vilson Peshkaj..

Me propozim të Kryetarit të SHAD, u zgjodhe struktura drejtuese e Këshillit:

- 1 Zonja Dukate Bregun, për Kryetare të Këshillit të SHAD
- 2 Zoti Viktor Arrinaj, për N/Kryetar të Këshillit të SHAD
- 3 Zoti Martin Ahi, për Sekretar të Përgjithshëm të Këshillit të SHAD

4 Zonjusha Diana Bungu, për sekretare e organizimit në Këshillin e SHAD

5 Zoti Ndue Nika, për sekretar me marrëdhënie me publikun të Këshillit të SHAD

Me propozim të Kryetarit të SHAD, u miratuam përbërjen e strukturës së Kryesisë së SHAD:

- 1 N/kryetari i përgjithshëm
- 2 N/Kryetari Pare;
- 3 N/Kryetari për ekonominë e financën e SHAD;
- 4 N/kryetari për veprimtaritë e SHAD
- 5 N/Kryetari për veprimtaritë mbi rolin e femrës në shoqëri;
- 6 Sekretari i SHAD;
- 7 Kryetari i Seksionit të Financës e ekonomisë;
- 8 Kryetari i Seksionit për veprimtaritë e përgjithshme;
- 9 Kryetari i Seksionit për veprimtaritë kulturore;
- 10 Kryetari i Seksionit për veprimtaritë artistike;
- 11 Kryetari i Seksionit në marrëdhëniet me Gruan;
- 12 Kryetari i Seksionit për historiografinë në SHAD

13 Kryetari i Seksionit për veprimtaritë me shkollat;

14 Kryetari i Seksionit për veprimtarinë me Rininë

15 Kryetari i Seksionit për veprimtarinë me librin

16 Kryetari i Seksionit për veprimtaritë turistike;

17 Kryetari i Seksionit për projektet;

18 Kryetari i Seksionit për Median

19 Kryeredaktori i gazetës "Dukagjini".

Po, me propozim të Kryetarit të SHAD u zgjidhen anëtarët e Kryesisë së SHAD:

- 1 Anton Kosteri,
- 2 Agron Hasanaj,
- 3 Arbër Shytani,



Fjala përshëndetëse e Dedë Prendaj në inaugurimin e lapidarit të T'lumnuemve

I nderuem Imzot Angelo Masafra, Ipeshkvi i Ipeshkvisë Shkodër-Pult, dhe meshtarë të pranishëm!

I nderuem kryetari i bashkisë Shkodër, z. Benet Beci

Familjarë të T'lumnuemve!

Të nderuem pjesëmarrës!

Jemi ketu sot, në zemër të Alpeve, në Dukagjinin tonë. Në kshpellën e Krishtianizmit shqiptarë, në djepin e identitetit tonë kombëtar, në këtë ceremoni modeste të kujtojmë "Martirët e fesë dhe kombit Shqiptarë; të T'lumnuem prej Selisë së Shenjtë;

1. AT Ciprian Nika, OFM
2. At. Bernandin Palaj, OFM
3. At. Gjon Shllaku, OFM
4. At. Gasper Suma OFM
5. Dom Dedë Plani
6. Dom Lazer Shantoja
7. Gjeloş Lulashi martirë laik

Këta Martir që mbajtën në genet e tyre brumin e truallit Arbënor Dukagjinas, të gatueme në magjen e kryeqendrës së kulturës e historisë sonë kombëtarë, Shkodrën tonë, e melmyeme me yndyrën akademike të Universiteteve më në za të Evropës, ishin dhe mbeten fondi ynë i artë i dijes dhe idealeve njerëzore. Ata ishin shërbëtor të përlun para Zotit dhe njerëzve, mësues të gjuhës, muzikës dhe historisë, teolog dhe filozof. Ishin urat kryesore lidhëse të Shqipnisë me qytetërimin perëndimor. Elita intelektuale shqiptare, me dije e kulture të stërhollueme, qytetare e perëndimorë e sidomos kleri katolik i Shkodrës, me institucionet e edukimit fetar e kombëtar shihej si pengese serioze e instalimit të pushtetit të ri politik me ideologji, që nuk bazohej në lirinë e ndërgjegjës, shtetin ligjor dhe pronën private. Prandaj heshtat e para të ushtarëve të Pilatit me yll, u drejtuan në mënyre despotike kundër objektivit të kultit, që të fshinte memorien kombëtare, që kombi ynë e kishte si mburoje në Ballkanin e trazuar në shekuj.

Martirët tanë nderojnë jo vetëm Dukagjinin dhe Shkodrën, por çdo pjesë të globit ku flitet gjuha shqipe. Ata me vprën e tyre i kaluan kufijtë tanë shtetëror. Lumturimi i tyre nga Selia e Shenjtë ishte një akt që shpërblen sakrificën njerëzore për liri, duke na bërë krenar që 7 prej tyre i përkasin Dukagjinit "Nderi Kombit".

Një përshkrim i shkurtër i jetë së T'lumnuemve:

1. **At Ciprian Nika**, lindi me 19 Korrik 1900, me emrin Dede Mhill Nika, prej lagjes Celajve të krahinës së Shoshtit.



Mbasi mbeti jetim nga nana, frati i Shoshtit e futi në kuvendin françeskan, i cili mbaroi me rezultate të larta. Vjoi studimet në Austri, ku shugurohet meshtar, në vitin 1924 dhe merr emrin Ciprian. Merr pjese në orkestrën frymore të At

Martin Gjokes. Ishte poliglot. U bë provinciali më i ri 1938 dhe ministër provincial në vitin 1943. Ndryshimet politike i nuhati, por ishte i vendosun në idealin e tij. Kapiteni duhet të jete i fundit që largohet nga anija, e cila po mbytet. Do të qëndroj, do të luftoj e do të flijohem për idealet mia.

Ashtu ndodhi; u arrestua, u dënua, u pushkatua me 11 mars 1948.

2. **At Bernardin Palaj**, lindi me 2 Dhjetor 1894, me emrin Zef Gjon Palaj, me origjinë prej fshatit Palaj të krahinës së



Shllakut.

Filloi shkollën Françeskane në Shkodër dhe mbaroi studimet në Salzburg të Austrisë. U bë frat në vitin 1918 dhe mori emrin Bernardin. Jepte mësim në shqip e latin në kolegjin ilirian. Shërbeu frat në

Pult dhe Rubik. Bashke editorial i gazetës "Ora e Maleve". Bashke me Donat Kurtin publikuen Këngët e kreshnikeve,

Studioi doket në trevat e Veriut.

U arrestua në Rubik dhe vdiq në burg prej tetanosit, në muajin Shkurt të vitit 1946, në moshën 53 vjeç

3. **At Gjon Shllaku**, lindi me 27 korrik 1907, me emrin Kole Loro Shllaku.

Ne kolegjin Françeskan mbaroi filloren dhe gjimnazin me rezultate të shkëlqueme. Në Noviciat, në Troshan mori emnin Gjon. Vjoi studimet per teologji në Holande. U shugurue meshtar në vitin 1931. U dergue per studie në Luvrain. Doktoroi në Sarbone, në Paris për filozofi. Drejtoi Djelmnine "Antoniane" në Shkodër.

Fishta, në shtratin e vdekjes i thotë at Gjon shllakut: "Po të le "Yllin e Dritës", kurse "Gomarin" po ta lidhi te porta e shtypshkronjës". Me 14 janar 1945 u krijua shtëpia e Artit në Shkodër, në cilin u zgjodh konferencier. U zgjodh anëtar i Frontit NAÇL, për Shkodrën, por ishte shumë i shkolluem për këtë soj tabori, që po merrte fuqi nga lindja.

U arrestua, pasi disa studente seminariste kishin krijuar organizatën "Bashkimi Kombëtar".

Radio Shkodra jepte me buje lajmin: "Arrestohet kriminelin Gjon Shllaku!". E çfarë krimi kishte ba në jete At Gjoni?

U dënua dhe u ekzekutua, me 4 mars 1946, bashke me Faustin, Dajanin, Mark Çunin, Gjeloş Lulashin dhe Qerim Sadikun...

4. **At Gasper Suma**, lindi me 23 Mars 1897, në familjen e njohur Suma dhe i vunë emnin Kole.

Mbasi mbari kolegjin françeskan shkon për studime teologjike në Insbrook të Austrisë. Shugurohet meshtar me 31 Korrik 1931, dhe fillon shërbimin si famullitar në fshatra të thella malore, në Theth, Brigje të Hotit, Toplanë, Nikaj dhe në Gomsiqe të Pukës,

U dallue për bamirësi dhe

- 4 Elida Delia,
- 5 Getjan Gropaj,
- 6 Gjergj Leqejza,
- 7 Fatmir Vojvoda,
- 8 Kolë Sukullari,
- 9 Kolë Çardaku,
- 10 Klodiana Serraj,
- 11 Leze Bungaja,
- 12 Ledia Dushi,
- 13 Marjana Koçeku
- 14 Niko Marku
- 15 Prelë Milani,
- 16 Roza Pjetri,
- 17 Sulela Ndoja,
- 18 Viola Shqau,
- 19 Vilson Peshkaj.

Të nderuar anëtar e anëtare të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", dukagjinas kudo jeni, u bëjmë me dije përbërjen e Kryesisë së Shoqatës Atdhetare "Dukagjini".

Në mbledhjen e pare të Kryesisë së

Shoqatës për perse vjet e ardhshëm, mandatin 2023-2028, me datën 14 tetor 2023, vendosi:

A) Funkcionet e anëtarësisë së Kryesisë janë:

- 1 Gjergj Leqejza – N/Kryetar i Përgjithshëm
- 2 Agron Hasanaj – N/Kryetari Pare;
- 3 Kolë Çardaku, N/Kryetari për ekonominë e financën e SHAD;
- 4 Roza Pjetri - N/Kryetare në marrëdhëniet me femrën
- 5 Prelë Milani, N/kryetari për veprimtaritë e SHAD
- 6 Anton Kosteri - Sekretari i SHAD;
- 7 Kolë Sukullari - Kryetarin e Seksionit të Financës e ekonomisë;
- 8 Fatmir Vojvoda - Kryetarin e Seksionit për veprimtaritë e përgjithshme;
- 9 Viola Shqau, Kryetarin e Seksionit për veprimtaritë artistike e kulturore;

10 Arbër Shytani, Kryetarin e Seksionit për veprimtaritë me shkollat;

11 Gentjan Gropaj, Kryetarin e Seksionit për veprimtarinë me Rininë;

12 Sulela Ndoja, Kryetarin e Seksionit për Median;

13 Elida Delia, Kryetarin e Seksionit për projektet;

14 Ledia Dushi, Kryetarin e Seksionit për veprimtarinë me librin;

15 Leze Bungaja, Kryetari i Seksionit në marrëdhëniet me Gruan;

16 Vilson Peshkaj, Kryetari e Seksionit për historiografinë në SHAD;

17 Marjana Koçeku, Kryetare e Seksionit për veprimtaritë turistike;

18 Niko Marku - për marrëdhënie me emigracionin;

19 Klodiana Serraj, Kryeredaktore e gazetës "Dukagjini".

B) Redaksia e gazetës "Dukagjini", përbehet:

- 1 Studiuiesi e publicisti Luigj Shyti
- 2 Studiuiesi e publicisti Prele Milani
- 3 Studiuiesi, publicisti e poeti Lazer kodra
- 4 Shkrimtari Lazer Stani
- 5 Publicistia Roza Pjetri
- 6 Publicisti Zef Nika
- 7 Profesor doktor Vuksan Kola
- 8 Profesor as, dr. Zef Gjeta
- 9 Doktorë, poetja Ledia Dushi
- 10 Profesor dr. Leke Sokoli
- 11 Profesor Edmond Tërthorja
- 12 Poeti e publicisti Lulash Brigja
- 13 Studiuiesi Vilson Peshkaj
- 14 Publicisti Prele Shytani
- 15 Publicisti Zef Bari
- 16 Publicisti Gjon Fierza
- 17 Publicisti Ndue Ziqi
- 18 Gazetari Gasper Marku
- 19 Gazetari Mark Gjeka

DUKAGJINI I KA PARLAMENTARËT E TIJ

Parlamenti i tretë Rural Shqiptar u mbajt me datat 11-13 tetor 2023 në mjediset e Universitetit Bujqësor të Tiranës

Një kuvend I rëndësishëm ku morën pjesë “parlamentarë nga i gjithë vendi” si përfaqësues të grupeve të ndryshme të zhvillimit në fshat, përfaqësues të disa ministrive dhe drejtorive të rëndësishme, përfaqësues të donatorëve dhe organizatave të ndryshme ndërkombëtare.

Tematika e Parlamentit të 3-të Rural Shqiptar - JETA BURON NGA FSHATI – përgatit terrenin për dialog dhe bashkëpunim konkret, për të analizuar realitetin dhe për t’u njohur më mirë me nevojat dhe problemet, për të reflektuar mbi vizionin dhe prioritetet si veprime kolektive me qëllimin final për të fuqizuar dhe përmirësuar cilësinë e jetës në komunitetet rurale në të gjithë vendin.

“Jeta buron nga fshati” shërben si një thirrje e fuqishme për veprim drejt nxjtes së zhvillimit të qëndrueshëm rural. Kjo temë thekson të vërtetën e madhe se zhvillimi dhe përparimi i Shqipërisë vjen nga zonat e saj rurale.

Parlamenti kombëtar rural përfaqëson përpjekjen më të qëndrueshme të avokatisë nga poshtë-lart, duke krijuar hapësirë për dialog dhe bashkëpunim, shkëmbim të këndvështrimeve rreth çështjeve të rëndësishme dhe aktuale të zhvillimit rural dhe bujqësor, si dhe për të ofruar

rekomandime për gjallërimin e jetës dhe ekonomisë rurale.

Parlamenti i tretë rural në vend vjen në një kohë, kur Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar dhe është në zbatim Ligji nr. 36/2022 për Grupet Vendore të Veprimit, duke krijuar një mundësi reale për të zhvilluar partneritete për fuqizimin e bashkëpunimeve vendore për zhvillimin e qëndrueshëm rural. Ky ligj është përafuar pjesërisht me Rregulloren (BE) nr. 1303/2013 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 17 dhjetor 2013

Por, përgatitja e aktorëve vendorë, njësisive të vet-qeverisjes vendore, biznesit dhe shoqërisë civile ende është larg një investimi të qëndrueshëm për të rritur besimin e aktorëve për t’u bërë bashkë për ndryshim. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural duhet të bëjë më tepër për të hapur proceset ndaj aktorëve të shoqërisë dhe të rrisë këtë bashkëpunim. Mbështetja e fermerëve apo sipërmarrjeve turistike rurale duhet të shoqërohet me ndërgjegjësimin e komuniteteve vendore duke i vlerësuar, le të themi “bujtinat” si instrument cilësor për fuqizimin e Grupeve Vendore të Veprimit të zonës. Kjo kontribuon në zhvillimin e qëndrueshëm, duke qenë se është investim në kapitalin njerëzor.

Midis pjesëmarrësve nga gjithë Shqipëria ishte dhe “Grupi parlamentar I Dukagjinit” në përbërjen tij kryesisht nga të rinjtë që punojnë dhe zhvillojnë veprimtarinë në Dukagjin në blegtori, bujqësi dhe ekoturizëm. Diskutimet e tyre morën vëmendje të veçantë, për përmbajtjen dhe mënyrën si u thanë shkurt dhe saktë.

Në seancë e parë plenare ndër të parët që mori fjalën ishte Gjergj Kodrari, fermer nga Pepsujat I cili pasi u prezantua dhe tregoi shkurt për veprimtarinë e tij dhe mjedisin ku e zhvillon, ju drejtua me tre pyetje përfaqësuesve të qeverisë dhe donatorëve pjesëmarrës:

Kur do të marrim banorët e Dukagjinit

dashni ndaj njerëzve. Konica e pershkruen At Gasper Sumen njeri të përvuajtur e me shpirt të madh.. E krahason me ndonjë “lartësi të ulun”, me shtatin e gjate dhe flokët e bardhe, me humor të holle, që kaloi gjithë jetën me arme në brez, ashte fjala për Kruzaren e fratit qe nuk e hoq kurrë nga xhepi.

U arrest dhe vdiqë në burg, me 14 prill 1950. U varros në kripë të kishës françeskanë.

5. Dom Dede Plani, lindi me 21 Janar 1891, në një familje shumë fetare, me origjinë nga Plani.

Studioi filozofi në Seminarin Papnor. Vijoi studimet për teologji në Insbrook të Austrisë, në kolegjin e Jezuiveve. U shuguroi meshtar me 31 gusht 919.

Shërbeu 30 vjet meshtar me përkushtim në fshatrat më të varfra të vendit. Në Gimaj të Shalës, Pog, Kir, Prekal, Shiroke, Renc dhe Gur i Zi. ku dhe u arrestua. U arrest dhe u torturoi në mënyrën ma çnjerëzore; Dom Deden nuk mund ta nxirnin në gjyq, sepse u mbeti në dore. Zoti e shpëtoi prej xhelatëve me kockat jashtë, me kurrizin vrima-vrima, me dhamë të thyem . Kalori pa gjyq në amshim si besimtar i Zotit. Me 30 prill 1948. U Varros prej familjare në varret e R'majit.

6. Dom Lazer Shantoja, ashte figure shumëdimensionale. Ka kenë frat, publicist, përkthyes, poet lirik, satirist.

Lindi me 7 Korrik 1891, me origjinë nga Vjerdha e Sipërme e Rragamit me prindër Kel dhe Luçe. Mbaroi seminarin papnor dhe studimet teologjike, në Austri. Në vitin 1917, u bë famullitar në Pulaj,, Beltoje, Velipoje, Rrjoll dhe Sheldi. U cakue në detyrën e sekretarit i Arkipëzhit të Shkodrës, Imzot Lazer Mjedes. Pas problemeve politike largohet në Aus-

tri dhe boton gazetën “Ora e Shqipnise”. Shërben për 15 vjet si famullitar në Kantonet e Zvicrës.

Kthehet në Shqipni në vitin 1939. Bashke me Koliqin krijojnë Institutin e Studimeve Shqiptare. U arrestua në Dhjetor të vitit 1944, u torturoi deri në gjymtim dhe ashte i pari, klerik që shkoi para togës së pushkatimit, me 5 Mars të vitit 1945.

7. Gjesh Lulashi 21 vjeç, gjithmonë i ri, 21 vjeç. Lindi me 9 Shtator 1925, në Ndreaj të Shoshit prej prindërve Lulash Gjeshi dhe Mire Vuksanja. Gjeshi kishte privilegjin që lindi në shpine e Bajraktarit të Shoshit një nder dyert më në za të Shqipërisë së Veriut, që i kane dhanë Shqipnise drejtues, që prej Lidhjes së Prizrenit dhe në qëndresat e Shoshit dhe të Dukagjinit kundër çdo pushtuesi, martire të fesë e lirive njerëzore.

Gjeshi në moshën 7 vjeçare bashke me kushrinin Pjeter Marku, regjistrohët në shkollën e fretnve minor në Shkodër. Mbaron me rezultate të larta Seminarin Papnor shqiptar. Fillon punën, në detyrën e sekretarit të spitalit civil në Shkodër.

Akuzohet si pjesëtar i organizatës “Bashkimit Kombëtar Shqiptar”, Gjykohehet me grupin e fretnve, dënohet me pushkatim. Bashke me te u dënuan me burg Pjeter Mark Delia, Peter Kokri i Toplanes, Ded Mhilli i Palajve e shumë të tjerë.

Në mëngjesin e 4 Marsit 1946, bataret e togës së pushkatimit i japin Shkodrës së terrorizuar e Maranejve lajmin e kobshëm të ekzekutimit të Gjeshit, Faustit, Dajanit, Shllakut, Mark Çunit e Qerim Sadikut. E ky ishte vetëm fillimi i kalvarit të dënimeve e pushkatimeve në Shkodrën e 19 burgjeve politike.

Në duhet ti kujtojmë me krenari “Martirët tanë”, por duhet të dimë të lexojmë mesazhet dhe amanetet që lanë;

Siç asht ba publike në fjalën e tyre të fundit, bie në sy edhe pse me akuza pa asnjë bazë, dhe me gjyqe të montueme, të drejtuar nga dora e Pilatit; ata dhanë mesazhin e faljes:

- I fali të gjithë ata që më kanë mundue, dënue dhe i fali ata që më ekzekutojnë... ashtu si Krishti që thoshte; jam kenë unë mëkatnori i shkretë, sepse ishin të vetëdijshëm si gjaku i shqiptareve ishte derdhë lumë. Ky ashtë një mesazh sa i shenjte dhe i qytenuem, që duhet dimë ta lexojmë edhe sot mbas 80 vjetësh, sepse ne shqiptarët i quajmë të dobët ata që kërkojnë falje. Ndjesa është edukatë dhe edukata nuk është instikt. Ajo fitohet në shkollë e në jetë. Ndjesa është kulture dhe integritet njerëzorë.

-Ata, që gjithë jetën në meshë dhanë predikimin e paqes. Për ironi të fatit nuk gjeten paqe, për veti deri sa fluturuen në shpi të vet në amshim,

-Si idealiste që ishin; e dinin se gjithçka në botë është e përkohshme dhe se Shqipëria një dite do bëhej e lire, dhe do kthehej në rrugën e besimit: “Rroftë Krishti Mbret!”. “Rroftë Shqipnia e lire!”, ishte fjala e tyre e fundit.

-Ata ishin qendrestare të pashoq, mes vuajtjeve e torturave nuk e lëshuan vetën, nuk e humbën shpresën.

-Lanë mbrapa mesazhin e dashnisë për Fe dhe Atdhe, që ishin të pandame për ta; dashnia për njerëzit, për kombin, flamurin dhe gjuhën e bukur shqipe.

Le të shërbejnë ky memorial si lule mbi landinë, për martirët tanë, për të T’lumuemit tanë, si vend homazhi e lutjesh, për ata që nuk kanë një varr, si

pikë reflektimi e kujtese në jetën tonë, si frymëzim e krenari për brezat e ri e meshtarët e rinj, si një lehtësim për të gjithë ata, që shkuen në amshim me shpirtin e brengosun për njerëzit e tyre, që nuk munden tu japin lamtumirën e fundit.

Le të shërbejë si relike e vogël, në gjerdanin e artë të historisë së Dukagjinit.

Njerëzit vdesin, por ne kurrë nuk i harrojmë!

Ne ju lutemi Martirëve!
Martirë të lumnuem lutuni për ne, për Dukagjinit tonë, për Shkodrën, për Shqipërinë tonë, para lumnisë së Atit të gjithëpushtetshëm!

Me këtë rast dua të përmendi me respekt dhe përvujtni kontributin e klerikëve të tjerë Dukagjinas, Dom Prek Nrevashaj, Pater Daneil Gjecaj, Pater Ambroz Martinin dhe patër Gegë Lumaj, që i shërbyen me devocion vendit dhe shqiptareve në tërësi brenda dhe jashtë Atdheut!

Një nderim të veçantë në kujtim të Dom Nikoll Gjinit prej Planit, që vuajti 25 vjet burg dhe vdiq në burgun e Hajmelit, ku u varros prej të burgosurve.

Një nderim i veçantë për At Luigj Palaj që në Mars të vitit 1913, u masakrua me bajoneta bashkë me 50 kosovare nga forcat serbe në rrugën Pejë- Gjakovë

E morën florinin dhe e tretën, në lllum, në lllagamin e zi. Pas 100 vjetësh kur e gjetën, Florini prapë ishte flori, shkruante një poet shqiptar.

Martirët tanë janë xhevahire, që shkëlqejnë edhe sot mbas 80 vjetësh, që bashkojnë njerëzit dhe japin energji pozitive.

Lavdi për jetë martireve të kombit tone!
Zoti e ruajt popullin e Dukagjinit!



“Certifikatat e pronësisë tokës dhe shtëpive ku banojnë” ?

Kur do bëhet subvencionimi real për prodhimet bujqësore në zonat e thella malore siç është Shoshi apo dhe fshatra të tjerë të thellë malor?

Kur do të kemi infrastrukturën e nevojshme të domosdoshme: rrugore, elektrike, ujësjellës, etj.

Janë këto nder shqetësime kryesore të banorëve dukagjinasi që jetojnë në fshat dhe të atyre që dëshirojnë dhe synojnë t'i rikthehen fshatit për të jetuar dhe zhvilluar atë.

Ishin këto pyetje objekt i një diskutimi të gjerë në seancën plenare të hapjes, duke i dhënë të drejtë z. Gjergj Kodrari për sa tha. Një nga pikat kryesore në deklaratën përmblylëse që do i dërgohet Qeverisë dhe Parlamentit Shqiptar ishte pikërisht zgjidhja përfundimtare e pajisjes me Certifikata pronësie për tokën bujqësore jo vetëm në Dukagjin por në gjithë Shqipëri.

Një parlamentare tjetër që tërhoqi vëmendjen me diskutimin e saj ishte dhe Marjana Koçeku e njohur tashmë si “Neomalsorja” (Malësorja e re). Marjana ishte pjesë e panelit të parë drejtues që përfaqësonte sipërmarrësit e rinj në rural. Ajo me një të folur të pastër dukagjinase u ndal tek problematika kryesore që ka veçmas zona ku ajo tashmë jeton dhe zhvillon veprimtarinë. Ajo përveçse mbështeti bashkrahinarin e saj, solli dhe disa aspekte të tjera që kërkohet mbështetje nga qeveria qendrore dhe pushteti vendor.

Ajo vlerësoi kontributin e të rinjve, duke sjellë disa shembuj real të veprimtarisë tyre si në: Shkodër, Mirditë, Dibër, etj. që janë të suksesshëm në zhvillimin e blegtorisë, në sipërmarrje për ekoturizëm që sakrifikojnë nga rinia e tyre, që fshati të marrë gjallëri. Na rinia po punojmë me moton “ Që nxënësi të jetë gjithmonë më mirë se mësuesi” Ne po përpiqemi por duhet mbështetje që fshati të marrin zhvillimin e merituar sepse pa një zhvillim bujqësor dhe blegtoral nuk mund të ketë turizëm por as jetë normale në fshat as në qytet. Unë ju bëj thirrje të rinjve të mos largohen nga Shqipëria vazhdoi Marjana. Të shkosh refugjat dhe të punosh nëpër ferma dhe punë të rëndomta nëpër Evropë është një lloj si të jetosh në “Gojë të Dreqit”. Ne duhet të ndërtojmë jetën tonë në trojet tona aty ku gjyshërit dhe baballarët tonë jetuan duke krijuar ato ngastrat, duke mbjellë pemë, atje midis shkëmbinjve në male, duke ju dhënë jetë atyre. Janë mijëra turist që i përshkojnë lumenjtë dhe malet tona, ne duhet të jemi të përgatitur ti presim. Nuk mjafton vetëm mikpritja shqiptare por duhen produktet dhe gatimet tradicionale në shërbim të turistëve. Natyra jonë është e mrekullueshme, nder më të bukurat në botë. Është sakrificë e pashembullt deri në jetë të rrezikuara pa përmendur mbi 17 mijë euro që u investuam ne si privat për të marrë energji elektrike nga fshatrat e Pukës për në shtëpitë tona buzë Drinit. Ne pritëm shumë kohë, por strukturat përgjegjëse po vazhdonin

ta zvarrisnin elektrifikimin tonë. Ajo ju bëri thirrje autoriteteve shtetërore që rruga automobilistike Vau i Dejës –Koman të kthehet në një rrugë normale për lëvizje. Ai aks automobilistik është ndër më të dëmtuarit në Shqipëri. Aty nuk është vënë dorë që para viteve 90. Ajo rrugë është një makth për kalimtarët, nëse nuk ndërhyhet shpejt do kthehet në një pengesë për turizmin në gjithë rajonin verior. Duke mbyllur diskutimin ajo tha: “Unë dhe shumë të rinj të tjerë nuk do tërhiqemi nga kjo sfidë, por do punojmë çdo ditë me përkushtim për të zhvilluar jetën në fshat, kërkojmë mbështetje dhe të gjithë së bashku do ja dalim, t'i bajmë ma të begatshëm malin dhe fushën. Ne meritojmë të jetojmë të lumtur në vendlindjen e të parëve tonë në kullat tona”.

Marjana Koçeku u duartroi disa herë gjatë fjalës saj. Ajo duke qenë shembulli dhe modeli më i mirë i një vajze të re intelektuale që nuk jep leksione, nuk bën teori e moral, por ato ç'farë thotë i ka realizuar vetë, kjo e beri atë të ishte një zë i fuqishëm, i besueshëm dhe frymëzues në atë parlament.

Ishte kënaqësi tek takova dhe “parlamentarë të tjerë dukagjinasi” si blegtorin nga Thethi Dedë Çobani, i cili të tregon për tufën e tij të deleve, tashmë më numër të konsiderueshëm krrerësh. Me familjen time kam arrite ta mbarësoj deri tani këtë tufë. Unë do kisha dëshirë ta shtoja në numër të thotë ai, por është vështirë të gesh çoban dhe baxhier. Ai thotë se

është prodhuesi dhe përpunuesi kryesor i bulmetit në parkun kombëtar të Thethit dhe në gjithë zonën e Shalës. Produktet që prodhoj, të gjitha konsumohen brenda fshatit. Ka shumë kërkesa për prodhimet e mia, e kam të pamundur ti plotësoj të gjitha. Ka dhe mjaft vështirësi shton Deda, pasi në dimër detyrohem të shtegtoj për në fushë, në rrethina të Shkodrës, pasi sigurimi i ushqimit është më i kushtueshëm. Parlamentarë të tjerë ishin dhe inxhinieri i pyjeve Fran Shkafja, kryetari e Shoqatës së pyjeve Sokol Guri, e të tjerë.

Ishte ky parlamenti ku dukagjinasi e thanë fjalën e tyre. Shpresojmë të jenë thënë në kohën e dhe vendin e duhur për zhvillimin e fshatit kur të gjithë shpresojmë për ditë me të mira.

“Jeta buron nga fshati” thekson rëndësinë e mbështetjes së ekonomive rurale, investimit në infrastrukturë dhe arsim dhe krijimit të mundësive për të rinjtë brenda komuniteteve të tyre. Tema nxiti të rivlerësojmë rëndësinë e komuniteteve rurale dhe ekonomisë së tyre në kontekstin e sfidave aktuale, duke përfshirë ndryshimet klimatike, migrimin nga zonat rurale etj.

Përmirësimi i cilësisë së jetesës në komunitetet rurale është e vetmja alternativë për ta bërë fshatin shqiptar tërheqës për të jetuar, punuar dhe ndërtuar të ardhmen.

Përgatiti
GJON FIERZA,
Tetor 2023

Inaugurohet statuja e Nënë Terezës në kishën “Notre Dame de Laeken” në Bruksel

Është inauguruar statuja e Nënë Terezës në Kishën “Notre Dame de Laeken” në Bruksel.

Kjo është bërë e ditur nga ambasadori i Kosovës, Agron Bajrami, i cili ka shkruar se inaugurimi i statujës së shenjtores shqiptare që mori Çmimin Nobel për Paqe.

“Paqja dhe dashuria mes njerëzve, në një botë plot mirësi, me Nënë Tereze si simbolin e saj, u festua në Meshën e Shen-

jtë, në Kishën Notre Dame de Laeken, në Bruksel.

Inaugurimi i statujës së shenjtores shqiptare dhe laureates së Çmimit Nobel për Paqe vetëm sa e theksoi mesazhin e paqes që Nëna Tereze barti në jetë dhe amshim”, ka shkruar Bajrami.

REDAKSIA



FESTIVALI NDËRKOMBËTAR I KULTURËS

“Foik Dances of Aibania” në WORLD CULTURE FESTIVAL - 2023. Në Festivalin Folklorik Ndërkombëtar - 2023 të organizuar në Washington DC të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për herë të parë u valvit edhe “Flamuri Shqiptar”, nën hijen e të cilit u kërcye edhe “Vallja e Shqipeve”, e cila pushtoi sheshin dhe dëshmoi me krenari se jemi shqiptar, se ka Shqipëri-AL.

Në këtë festival folklorik, i cili zgjati tre ditë rradhazi, morën pjesë grupe folklorike nga 148 shtete të botës. Festivalin e ndoqën mbi 450 mijë spektatorë, të cilët kishin pushtuar sheshet dhe prisnin me padurim të ndiqnin performancat kulturore nga e gjithë bota. Këto organizime bëjnë që bota të flasë vetëm me një gjuhë, me gjuhën e folklorit, e cila bën që pupujt të mirkuptohen e të kultivojnë mbi tokë paqe globale.

Për të mbështetur e përshëndetur Ansamblin Folklorik të Valleve Shqiptare të Michiganit, kishin ardhur delegat shumë bashkëatdhetar nga shtetet e Çikagos, Bostonit, Virginias, Nju Jorkut dhe Michiganit. Ky Ansambël u kompletua falë një bashkëpunimi vëllazëror mes dy aktivistëve dhe patriotëve shqiptar, z. Anton Marku Juncaj dhe znj. Elvana Dedvukaj, të dy koreograf me grupet respektive folklorike “Rapsha” dhe “Dance with Elvana”. Ra në sy kostumografia e larmishme tradicionale, e cila përfaqson një pjesë të mirë të trevave shqiptare. Veç FLAMURIT, simbolit tonë Kombëtar, valltarja e grupit folklorik “Rapsha”, Teuta Juncaj, për të prezantuar para botës Ansamblin Shqiptarë, mbante edhe një fotografi dëshmi të Bijës Shqiptare, Nënë Terezës, Shenjtores së Kalkutës, Misionares së Paqes në Botë, e cila i dha edhe më shumë identitet performancës së grupit.

Në këtë prezantim secili nga valltarët dha maksimumin e tij, ndaj u shpreh mirënjohjet më të sinqerta secilit nga artistët, emër për emër, për krenarinë që na dhuruan dhe që na mirë përfaqëuan para të gjithë botës.

Anton Marku Juncaj me Grupi Folklorik “Rapsha” dhe Elvana Dedvukaj me Grupin Folklorik “Dance with Elvana” paçi vetëm suksese e mbarësi në veprimtari dhe misionin tuaj fisnik!

Paçi faqen e bardhë se na nderuat para botës!

RITA SHKURTAJ



NJË DJALË DUKAGJINI RRËMBEN ÇMIM TEK “MIKROFONI I ARTË - VAÇE ZELA”

Sot me disa miq artiste ishim të ftuar në Festivalin „Mikrofoni i Artë - VAÇE ZELA”, organizuar nga Shoqata KGV Lushnje, me kryetar z. Adriatik Gega dhe Bashkia Lushnje.

Një festival prefekt dhe mikpritje shumë bujare nga organizatorët. Ne jemi rritur me këngët dhe zërin e këngëtares Vaçe Zela, por ti dëgjosh përsëri të interpretuara nga brezi i ri është emocion i veçantë. U ngjiten në skene zëra dhe talente të rinj, nga Shqipëria: Tirana, Durësi, Vlora, Lushnja, Korça, Shkodra, Librazhd, Bulqiza, Saranda, Fieri, si dhe nga Gjermania, Italia, Maqedonia e Veriut, Kosova dhe Mali i Zi. Një moderatorë e ëmbël dhe miqësorë freskoj emocionet e artisteve të vegjël.

Zëra të rinj, artist të talentuar, aty ku jehonte kënga e bukur nën tingujt e muzikës shqiptare, po ku tjetër veç se në Lushnje.

Një këngëtare si artistja e madhe Vaçe Zela “Nderi i Kombit” krijoi përshtypjen sikur Ajo sot ishte me ne, në sallën mbushur plot me zërat e bilbilave dhe kanarinave na bën të krenohemi me zërat e tyre magjik, që jehonin me ato drithërimat mbushur plot dashuri, emocione, lumturi dhe krenari.

Lushnja sot për herë të dytë organizoj Festivalin e zërave të rinj, ‘MIKROFONI I ARTË’, pra, kushtuar këngëtares së pavdekshme Vaçe Zela, ku përmes këtij Festivali artistëve të rinj iu mundësia pjesëmarrja për ta zbuluar talentin e tyre dhe për të komunikuar me shpirtin e tyre artistik dhe botën e tyre plot mirësi e dashuri.

Çmimet fituese ishin:

Vendi parë: Kit Hitha nga Vlora.

Vendi dytë: Rigerta Kojku nga Librazhdi.

Vendi i tretë: Arbias Pepa nga Lushnja.

Çmimi i publikut: Kevin Koneta, një artist i cili jeton në Itali dhe këndon për Shqipëri!

Personalitet të artit dhe kulturës nga krejt Trojet Shqiptarë e nderuan këtë veprimtari.

Nder shumë pjesëmarrës ja vlen të veçojmë jurinë profesionale e kryesuar nga maestro Zhani Ciko, Atristen e Merituar zj. Margarita Xhepa, këngëtares Justina Aliaj dhe Shkodran Tolaj.

Shumë miq dhe koleg takova aty nder të cilët dua t veçoj aktorin Xhevat Limani, z. Minella Kureta,

z. Nikoll Camaj. Mikun tim Can Tahiri, që vinte enkas nga Gjermania e shumë të tjerë. U ndjeva krenar kur mes fituesve të çmimeve ishte edhe një djalë nga fshati i Thethit, qendra e Alpeve Shqiptare, i cili vinte nga Italia për këtë festival.

Kur u bë prezantimi mbiemërim i tij më ngacmoj kureshtjen, por kur u dhanë vlerësimet nga juria dhe ai ishte një nga fituesit, pas programit e takova.

Familja e tij jetonte prej shumë vitesh në Itali, u prezantuam dhe pash që u ndien krenar, që edhe dikush nga Shkodra e duartrokiti djalin e tyre të talentuar. Menjëherë mendova diçka më larg se çasti, sa

borxhli jemi ne dhe sa dëshire kanë ata të mbajnë lidhjet me vendlindjen.

Kevi Kometa edhe vetëm njeri nga ata talente Shqiptar, Shkodran apo Dukagjinas që ka dëshire të këndoj shqip, të shkruaj shqip, të ëndërroj shqip.

Nga thellësia e shpirtit i thërret zëri i

vendlindjes, dashuria që prindërit ju kanë injektuar për gjithçka Shqiptarë

Jeta e secilit nga ne matet me çastet e bukura që kalojmë në jetë, me gjurmët që puna jone le për shoqërinë dhe brezat. Sot ishte vërtet një aktiveprimtari me vlera të larta artistike dhe kulturore, një dite e bu-

kur për çdo pjesëmarrës.

Kam shumë gjera për të shtuar, por po mjaftohem me pak fjalë, shumë kujtime dhe disa foto pikante.

Faleminderit z. Adriatik Gega, respekt për ju dhe punën tuaj!

Përgatiti: LULASH BRIGJA



Mbi globalizmin dhe imagjinatat e deformatuara antiglobaliste

- KRITIKE PËR LIBRIN- Globalizmi dhe përfytyrimet provinciale antiglobaliste



Shkruar nga FRAN GJOKA

Rreth librit: "Globalizmi dhe romantizmi antikapitalist" të "Mjeshtrit të Madh" Gëzim Tushi

Vijon me intensitet punën e vet studimore, hulumtuese e krijuese sociologu, Gëzim Tushi, si gjithnjë, të fokusuar në fushat e gjera të sociologjisë dhe problemeve sociale, të filozofisë, psikologjisë dhe shqetësimeve ekzistenciale, që ka sjellë koha postmoderne dhe në politologji. Gjithnjë autori me tendencë të qartë është i fokusuar në diagnostikimin e fenomeneve psikologjike, materiale dhe efektet sociale që ato reflektojnë në jetën e shoqërisë tonë.

Besoj se edhe libri i tij duket intrigues që në titull "Globalizmi dhe antikapitalizmi romantik", i njëzet e dyti në kolanën e librave të tij në fushë të sociologjisë dhe politologjisë, është interesant për objektin e tij, mënyrën optimiste të trajtimit të efekteve dhe kundërefekteve të globalizmit në shoqërinë e sotme universale, por edhe në nivel kombëtar. Një libër me tematikë jo të lehtë për t'u trajtuar, për shkak të optikave optimiste dhe pesimiste që përplasen me njëra-tjetrën. Edhe pse globalizmi, sikurse thotë autori, po bëhet rendi natyror i kohës postmoderne, këtë dilemë e ka ndjerë autori, i cili për t'i dalë përballë gjykimeve apo paragjykimeve të mundshme pranon se kur fillova punën për këtë libër, isha i bindur për hermeneutikën kontroversale delikate, një temë e shenjtëuar dhe anatemuar njëkohësisht. Duke qenë i imunizuar nga "sindroma e imposterit", e vetëdyshimit, pa pasur frikë për të thënë atë që mendoj, isha dhe jam i bindur dhe besoj në mënyrë të patundur se globalizmi mbetet e ardhmja e njerëzimit. Në libër jam investuar gjerësisht me argumentime kundër idesë simpliste se "globalizmi do sjellë një çorbë kulturore e padiferencuar".

Përballë sfidave të gjykimeve dhe rreziqeve të keqkuptimeve të mundshme, ai thotë se jam mundur të argumentoj se ideja që globalizmi do të jetë shkak që mund të ndodhë një "rrafshim kulturor" nuk është e vërtetë. Kjo ide është fare e gabuar, metafizike, cinike. Me gjithë ndryshimet që do sjellë efekti i pashmangshëm i globalitetit kulturor, ai megjithatë nuk do mund të mjetullojë plotësisht veçanësitë kulturore të popujve në sfondin e përgjithshëm të qytetërimit global.

Kur unë kam biseduar kohë më parë me autorin e librit, ai kishte idenë që titulli të ishte "Kush ka frikë nga globalizmi?". Me sa duket gjerësia e problematikës dhe zgjerimi i shqetësimeve që po shfaqen midis perspektivës së globalizmit dhe shkaqeve të shumta të pasigurive, e ka detyruar atë të zgjerojë lëndën dhe trajtesat. Duke marrë parasysh edhe pëlqimet dhe mospëlqimet e njerëzve, jo aq shumë të kënaqur nga efektet dhe kundërefektet aktuale të globalizmit. Megjithatë autorit i vjen në ndihmë gjykimi elegant i Presidentit të ShBA-ve Barack Obama, i cili shkruan se "...nuk besoj se mund të ndalonim apo të zhbënim globalizmin, ashtu siç nuk mund të fikim internetin.

Autori është realist përballë vështirësive të gjera të kësaj teme. Prandaj ai thotë se angazhimi im nuk ka qenë i lehtë për t'ia dalë mbanë. Kur e nisa punën vite më parë u mbështeta në vëzhgimin e kujdesshëm të "dialektikës" së ndryshimeve në këtë shekull që jetojmë, në studimin e realitetit politik, social, ekonomik, kulturor. Por më është dashur një punë jo e vogël për të analizuar idetë e filozofëve, sociologëve, mendimtarëve social, politologë e intelektualë të shquar, të cilët kanë ndërtuar dhe kanë sjellë paradigma dikotomike, herë optimiste, sipas të cilës "ideja e globalizmit, do të bazohet tek bindja se emëruesi i përbashkët dhe se baza e ndërtimit të tij do të jetë konsolidimi i gjerë i demokracisë në nivel planetar. Por në shumë raste edhe nacionaliste, skeptike, pesimiste për të ardhmen e pasigurt të tij.

Sociologu Tushi e trajton temën e gjerë të globalizmit në dy rrafshë: konceptual dhe kontekstual. Madje ky komponent i dytë zë peshë në lëndën e librit, duke evidentuar procesin e ndërlikuar të kalimit nga shoqëria e mbyllur dhe sistemi totalitar në shoqërinë moderne, të hapur dhe me prirje drejt globalizimit. Sepse ai mendon se globalizmi, pavarësisht vështirësive kalimtare, do të bëhet "ideologji planetare". Në këtë kontekst ai nuk pajtohet me konceptime të ngushta skeptike, cinike, provinciale e antiglobaliste.

Globalizmi është një realitet që mund të kuptohet me "mendje të hapur" dhe kjo është një nga detyrat e njerëzve që kanë idetë e duhura për të qenë "strategjistë të globalizmit", duke argumentuar se kjo është rruga e zgjerimit të të drejtave të njeriut në botën postmoderne, që do të ndikojë pozitivisht në karakterin universalizues të vlerave të qytetërimit në epokën tonë. Bashkekzistenca qytetare në botën e globalizuar do të shoqërohet, thotë autori, me patjetër edhe me ndryshime thelbësore në mënyrën e jetesës. Sipas tij kuintesenca e globalizmit do jetë "shumë kultura e mënyra sjelljeje dhe një njerëzim". Doemos duke "sulmuar" imagjinatat e deformatuara dhe konceptet paranojake të antiglobalistëve, Gëzim Tushi për ta zhvilluar teorikisht këtë sfidë të globalizmit si alternativë dhe e ardhmja e këtij shekulli, trajton gjerësisht edhe mënyrat e reja të shfaqjes së humanizmit, komunitarizmit e solidaritetit global.

Bota nuk mund të bëhet globale dhe globalizmi nuk mund të bëhet funksional pa një kartë të "humanizmit dhe solidaritetit universal". Një solidarësi që mund të kapërcejë kombet, bashkësitë, etnitë, por pa prishur kushtet e gëllimit të kulturave. Kjo do të thotë se në disa drejtime globalizmi do të zbusë forcën e egër të "përkatesive të trashëguara" që në epokën paraglobale i kanë shoqëruar njerëzit dhe qytetërimet që nga djepi deri në varr. Solidaritetet e vjetra, të kufizuara kulturalisht, ekonomikisht dhe etnikisht nën ndikimet transformuese të globalizmit do të kapërcejnë kufijtë e trashëgimive dhe përcaktimeve të vjetra të tyre.

Sociologu Gëzim Tushi i kushton jo pa qëllim një pjesë të konsiderueshme të librit të tij, çështjeve të ndërlikuara të raporteve midis kombëtares dhe globale, lokale dhe planetare, mënyrës etnike dhe jetës postmoderne në hapësirën e globalizuar. Problemet e globalizmit dhe ruajtjes së identitetit kombëtar janë trajtuar me kujdes, duke parë anën e ndritur, por dhe problemet jo aq shumë të lehta për t'u koordinuar e zgjidhur në mënyrën e duhur. Prandaj autori tregohet i matur kur vjen fjala për raportet e globalizmit me diversitetet, të çdo natyre qofshin ato si dhe për mundësinë e shfaqjes edhe të "rreziqeve të pakontrolluara".

Pavarësisht vështirësive, dyshimeve dhe skepticizmit autori ngul këmbë dhe argumenton tezën se bota në kohën e sotme po kalon nga një gjendje fragmentarizimi drejt globalizmit integruar. Të gjithë mendojnë se globalizmi është një stad i ri në rrugën e evolucionit të njerëzimit. Kjo rrugë globale ka nevojë për strategjistë dhe njerëz mendjehapur. Ky stad ka të pashmangshëm rrugën e ecjes së përbashkët drejt dimensioneve të reja të integritetit global. Është e pritshme që sa më globale të bëhet bota dhe sa më i globalizuar të shfaqet njerëzimi, aq më shumë do të ndihet i çliruar nga tensionet e panevojshme e të tepërta nacionaliste. Globalizmi në mënyrë të pashmangshme do të sjellë jo thjeshtë ndryshim, por shndërrim të njerëzimit. Gëzim Tushi ngul këmbë se pavarësisht vështirësive kalimtare, është e sigurt që do të marrë kuptim tjetër kalimi nga integrimi nëpërmjet kombit në një integritet të përgjithshëm, që po përfshin tërë njerëzimin. Kjo do të thotë se ajo që pritet nga zhvillimet globale është vlerësimi i forcës së tij për të ndërtuar "shoqërinë e njeriut global", sepse, sikurse thotë autori, në një botë të globalizuar do të jetë e mundur që jo vetëm njerëzit të jetojnë së bashku, por edhe ta kuptojnë njëri-tjetrin. Autori merret gjerësisht me problemet e ndërlikuara të raportit midis globale dhe kombëtares, për garancitë dhe pasiguritë që e shoqërojnë këtë simbiozë delikate, që do rregullojnë raportet dhe marrëdhëniet midis globale dhe lokale, midis mënyrës universale dhe mënyrës etnike të të jetuarit në kohën e sotme.

Autori përqendrohet me tendencë në sqarimin e paqartësisë që qarkullojnë në opinionin publik se globalizmi do të jetë shkak për rrafshim kulturor.

Kjo tezë, mendon sociologu Tushi, është fare e gabuar, metafizike dhe cinike. Globalizmi nuk është kundër tendencës së qytetërimit postmodern për të mbrojtur të drejtën e afirmimit të identitetit kulturor. Autori i librit "Globalizmi dhe romantizmi antikapitalist" është i mendimit që me gjithë ndryshimet që do sjellë efekti i pashmangshëm i globalitetit kulturor, ai megjithatë nuk do mund të mjetullojë plotësisht veçanësitë kulturore të popujve në sfondin e përgjithshëm të qytetërimit global. Por nga ana tjetër sociologu Tushi mendon që duke parë këtë realitet është normale që për të qenë në kompatibilitet me kohën dhe raportet identitetit me globalizmin kulturor është e udhës që herë të flitet për "qytetërimet" njerëzore dhe herë për "qytetërimin" njerëzor.

Globalizmi do të ndihmojë për të kapërcyer "konceptimin fisnor" për kulturat dhe qytetërimet e parcelizuara nga identitetet e ngurta, por në të njëjtën kohë globalizmi nuk mund të sjellë një "çorbë kulturore" të padiferencuar që vjen nga mungesa e respektit për integritetin fizik e moral të njeriut. Globalizmi ka potencë që të krijojë një "qytetërim njerëzor", i cili do mund të shpalojë përmes diversifikimit kulturor të pafund.

Sociologu Tushi është i mendimit se kultura dhe përparësia e saj në globalizëm duhet bërë "disiplinë e mbijetesës planetare". Që të ecim normal dhe të ekuilibruar në epokën e globalizmit është e udhës që të kuptojmë imperativin e madh dhe nevojën e ndryshimit të zakoneve dhe përparësive që kemi në jetë. Kjo do të thotë se duhet të dëgjojmë më mirë dhe me vëmendje më të madhe zërin e botës ku "kemi zbarkuar". Sociologët në mënyrë sintetike e metaforike thonë se në botën globale njerëzit nuk mund të jenë më të "huaj" për njëri-tjetrin, pavarësisht nga identitetet e tyre të trashëguara. Përkundrazi globalizmi do t'i bëjë planetarisht njerëzit vetëm "shokë udhëtimi". Kjo do të thotë se globalizmi do krijojë kushte humane të tilla që diversiteti njerëzor të shprehet nëpërmjet një bashkekzistencë të harmonishme dhe pa tensione që prodhojnë dhunë. Ky është globalizmi i cili nuk mund të bëhet pa krijuar kushte për një unitet të ri global të "aventurës njerëzore".

Në këtë kontekst, sipas autorit, që në globalizëm të ndryshojë edhe trajta e zhvendosjes dhe integritetit të njerëzve. Me gjithë përpjekjet e bëra deri tani, pavarësisht ndryshimeve që kanë ndodhur pas rënies së Murit të Berlinit, një gjë është fare e qartë. Deri tani nuk ka funksionuar si duhet "makineria e integritetit" të emigrantëve dhe atyre që duan të lëvizin apo të emigrojnë. Njerëzit kanë shumë shpresa nga zhvillimet globale dhe efektet e globalizmit. Por ajo që ata presin më së shumti është kapërcimi i atmosferës globale për emigrantët, e cila është e mbuluar nga ankthi, frika, mosbesimi dhe mllefi.

Të gjitha këto ide, dilema, gjykime, analiza e prognoza janë të sintetizuara në librin e sociologut Gëzim Tushi, i cili ka pak ditë që ka parë "dritën e botimit" dhe tashmë është në duart tuaja...

Mbi 100 vjet asnjë vrasje në fshatin Zogaj



Dr. Skënder Demaliaj

Edhe në Tropojë si në gjithë Shqipërinë, pas hapjes së depove ushtarake në vitin 1997 ka pasur vrasje. Nga një pjesë e gazetarëve (vendas dhe të huaj), me qëllime të caktuara, padrejtësisht, shpesh në mënyrë spekulative, Tropoja vitet e fundit është paraqitur si vend i krimit dhe tropojani si kriminel. Nuk është e vërtetë... Në Zogaj, në kufi me Kosovën, 60 km larg nga Bajram Curri ka mbi 100 vjet që nuk ka ndodhur asnjë vrasje. A nuk janë edhe këta banorë tropojanë?... Rasti në fjalë ka shpjegimet e tij historike dhe etnopsikologjike.

Cilat janë mekanizmat që i bënë banorët e fshatit Zogaj të ruajnë të paprekur unitetin e tyre, të jetojnë, të punojnë, të gëzojnë së bashku si një familje e madhe, pa inate, zemërim, mllafe, zënka, grindje e vrasje me njëri-tjetrin?...

Cilat janë ato rrënjë, që e kanë ushqyer vijimisht tokën e fshatit Zogaj, për të mos u tharë kurrë gjaku shqiptar, ideali shqiptar, karakteri shqiptar?

Ruajtja e traditave më të mira të familjes shqiptare

Familja e madhe (në numër) është karakteristikë për fshatin Zogaj. Kjo traditë u ruajt deri në ditët e sotme, ndryshe nga krahinat e fshatrat e tjera të Tropojës. Ka një ngjashmëri me familjen kosovare, me të cilën bytyçasit patën lidhje të ngushta gjaku, ngjitur me njëra-tjetrën, por që padrejtësisht Fuqitë e Mëdha të Evropës i ndanë më 1913. Në Zogaj janë ruajtur elementët më qenësorë të familjes së Veriut: dhoma e burrave, roli i kryefamiljarit në organizimin e punëve dhe drejtimin e familjes, respekti për më të rriturit, veçanërisht për të moshuarit. Ata thirren me emrin karakteristik "Baca". Burra me zë në Zogaj si: Hoxhë Zogu, Myftar Sylja, Arif Ahmeti, Rexhep Alia, Zmajl Zymeri, Vehbi Jonuzi, Hysen Kadria, Xhemajl Neza, Faslli Muzia, Brahim Rexha, Musë Avdyli qenë gjithmonë elementë pajtimi e mirëkuptimi. Marrëdhëniet prindër-fëmijë në Zogaj janë marrëdhënie partneriteti. Fëmijët atje nuk ndëshkohen fizikisht. Fjala e tyre dëgjohet nga më të mëdhenjtë. Ata i duan dhe i respektojnë prindërit e tyre. Nuk mbahet mend të ketë pasur konflikte prindër-fëmijë. Uniteti në familje ka përcaktuar edhe unitetin në fshat. Zogajt janë shembulli konkret, që tregon sa i domosdoshëm është konsolidimi dhe forcimi i familjes shqiptare. Më pak kriminalitet, më pak drogë e prostitucion, më shumë harmoni e dashuri. Më shumë paqe midis njerëzve, më shumë dije, më shumë energji në shërbim të bashkësisë për rritjen e mirëqenies.

Ku ka mirëqenie, ka më pak krime, më shumë bashkëpunim e solidaritet

Në Zogaj çdo shtëpi e ka një familje që banon ende atje, në fshat, nuk janë larguar të gjithë. Vendi është i përshtatshëm për zhvillimin e blegtorisë e të bletarisë. Fusha e Zogajt është nga më të njohurat në malësinë e Gjakovës për sasinë e barit, ka kullota në Majën e Fushave dhe Bjeshkën e Sylbicës. Tradicionalisht shumë familje kanë mbarështruar me qindra krerë bagëti. Lulja e trumzës e përhapur në të gjithë zonën ka rritur sasinë e bletëve dhe të mjaltit. Ngjitur me shtëpitë të zë syri terraca të punuara bukur, me mure të qëndisura, të mbjella me mollë, rrush, dardha, qersh e kumbulla. Ka puse uji të rregulluara bukur për ujitje. Në çdo shtëpi ka ujë të pijshëm. Sektori i minierave ka ndihmuar në rritjen e mirëqenies. Aty ka vendburime të shumta me mineral të pasur kromi.

Zogajt e patën dhuratë nga Zoti: tokën, kullotën, mineralin dhe i shfrytëzuan me efektivitet. Shumë prej tyre pas viteve '90 u bënë sipërmarrës të kromit. Tregtinë e zhvillojnë me Gjakovën nëpërmjet Qafës së Prushit. Në spitalet e Gjakovës kuro-



hen dhe në shkollat e Kosovës arsimohen. Kanë mësuar nga mençuria, toleranca dhe gjakftohtësia e gjakovarëve.

Banorët e Zogajt janë bujarë. Ku ka bujari ka fisnikëri, ka dhimbje e dashuri për njërit. Volteri thoshte: "Puna të largon tri të këqija: vesin, nevojën dhe mërzinë!" E përkthyer kjo në gjuhën e pleqve të Zogajt: "Ai që nuk punon është ngatërruar e i pa marrun vesh; dembeli është gjithmonë i unshëm për të bërë gjëra të këqija e të liga". Është kjo arsyeja që në Zogaj të gjithë punojnë. Edhe në mërgim djemtë e fshatit Zogaj dallohen për punë të ndershme dhe sjellje qytetare. Asnjë ngjarje e hidhur apo incident nuk u ka ndodhur. Punët e mëdha: kositjen, vjeljen e prodhimeve të vjeshtës gjithnjë i kanë bërë së bashku dhe së bashku i bëjnë edhe në ditët e sotme. Kështu përballohen me sukses, forcohet ndjenja e kolektivitetit, rritet prodhimi. Ku ka me shumice ka më pak vjedhje. Zënkat, rrahjet, vjedhjet të çojnë në krime të rënda, në vrasje. Varfëria e kalbëzon njeriun, karakterin, dinjitetin, moralin e tij. Kjo është arma më vrastare për të shpërbërë një komb.

Fjala e urtë bytyçase: "Më mirë tre groshë të hallallit, se treqind të haramit", është rrënjësorë prej shekujsh në vetëdijen e banorëve të Zogajt.

Respektohet ligji, respektohet shteti. Kryepaqësia është në lartësinë e duhur të detyrës dhe të përgjegjësisë.

Soloni poeti i lirikës antike greke i këshillonte athinasit: "Sundimi i keq s'i sjell tjetër qytetit veçse të zeza, të zeza pambarim, ndërsa sundimi i mirë sjell vetëm rregull e harmoni të përgjithshme dhe të këqijtë

i hedh në pranga, zbut dhe egërsimet, frenon mendjen e madhe, shuan çdo dhunë, mjerimit ia than lulet, drejtësinë e çalë e bën të drejtë, kryelartë se, i vë fre dhe grindjet qytetare i dërmon fare, zëniet të përgjakshme ua pret furinë dhe për hir të tij urti e rregull njerëzit gëzojnë".

Veçoritë psikologjike të njerëzve në Zogaj

Janë të shoqërueshëm, gjakftohtë, të durueshëm, mirënjohës, bujarë, të sjellshëm, fjalëmbël, tolerantë dhe me zemër të madhe. Shoqërinë e kanë të pastër, nuk dinë t'i bëjnë hile njëri-tjetrit. Po bisedoja një ditë me një të moshuar,

të një grupi njerëzish. Me fjalë të tjera, një kulturë e veçantë shfaqet sa herë një grup njerëzish gjejnë mes tyre konsensusin për mënyrën dhe arsyen e realizimit të gjërave. Banorët e Zogajve e kanë këtë kulturë dhe bashkërisht e realizojnë atë që është më e mira dhe në dobi të bashkësisë.

Në Zogaj padrejtësia që i bëhet njërit konsiderohet se u bëhet të gjithëve – na thotë dhe njëkohësisht kryeplaku, Ibrahim Hajdarmataj, i cili gjendet pranë hallevë dhe shqetësimeve të njerëzve në çdo çast. Drejtësia është burim i përbashkët i të gjithë virtyeteve, por edhe i trimërisë qytetare, urtësisë dhe ndershmërisë. Shekspiri thoshte: "Drejtësia jo vetëm duhet të bëhet, por edhe duhet të shihet sesi bëhet!"

Sipas statistikave në këto 30 vite numri më i madh i vrasjeve është në vitin 1997 – 1542 të vrarë. Atëherë kur shteti kishte rënë dhe popullsia ishte armatosur po të thuash 100%. Në këtë vit numri i vrasjeve në Zogaj është zero, madje as konflikte nuk ka. Po sipas statistikave 20% e vrasjeve në këto vite janë për konfliktet që lidhen me pronën. Në Zogaj të gjithë e respektojnë pronën e njëri-tjetrit, askush nuk tenton t'ia marrë atë. Krimi trimërohet kur njerëzit janë indiferentë, nuk e godasin e nuk e luftojnë atë për ta parandaluar. Krimi në Zogaj ndeshet në rezistencë të pandërprerë. Lufta kundër tij është një qasje e gjithë shoqërisë, bashkëpunimi është në të gjitha nivelet. Asnjëherë nuk është konstatuar ndonjë parcelë e mbjellë me hashash në Zogaj, madje as nga djemtë e fshatit që punojnë jashtë nuk ka asnjë përdorues dhe të dënuar për drogë.

Pabarazia ekonomike, përjashtimi politik dhe social, mungesa e qasjes në shërbimet kryesore – janë shkak i mosmarrëveshjeve, i konflikteve dhe i krimeve. Në Zogaj këto shkaqe nuk ekzistojnë.

Shoqëria që duam është: promovimi i vlerave të drejtësisë, iniciativa e lirë, shoqëria që punon si një trup i vetëm për një ekonomi e të ardhme më të mirë e më të sigurtë. Ejani në Zogaj dhe do ta gjeni atë. Varfëria e shpresave është faktor pengues në përpjekjet e një shoqërie për të ecur përpara. Banorët e Zogajt aspirojnë, besojnë e shpresojnë për ditë më të bukura e të lumtura. Kjo rrit mobilizimin, entuziazmin, bashkimin, dëshirën për të jetuar gjatë e me nder. Mortaliteti i një shoqërie me të vërtetë demokratike, autoriteti i ligjit kërkojnë përputhjen e fjalës me veprimin. Banorët e Zogajt janë njerëz të fjalës, të besës e të veprimit.

Njerëzit në Zogaj kanë të drejtë morale e legjitime të mblidhen së bashku. Të veshur bukur, me rroba kombëtare, me tupan, çifteli, fizarmonikë e altoparant të shkojnë në fshatrat e Tropojës e në gjithë Shqipërinë dhe me zë të lartë t'u drejtohen shqiptarëve: "Ndaloni vëllavrasjet! Duajeni dhe bashkohuni me njëri-tjetrin! Pak gjak shqiptari është derdhur deri më sot?!" E për veprimtari të tilla nuk duhet të kursehen lekët nga shteti dhe nga organizatat joqeveritare... janë efektive, tepër domethënëse. Jemi të vonuar...

Në thelbin e saj, një kulturë përcaktohet nga normat dhe vlerat e përbashkëta

DUKAGJINI - SHQIPËRIA IME ATY III

Publicistikë, me autor Ndue Sanaj, një refleksion malli, nostalgjie, krenarie, respekti dhe dashurie për vendlindjen e tij e njerëzit e saj

Është një libër që përcjell vlera, virtyte, mbresa, emocione, histori, kulturë, zakone dhe tradita, bujari, qëndresë dhe atdhetari, me njerëzit e ditur dhe fisnikë, që me punën dhe dijet e tyre kontribuojnë dhe lartësojnë këtë trevë kreshnike si Dukagjini, që ka lënë gjurmë të pashlyera në histori, pjesë e së cilës është dhe autori i mirënjohur i këtij libri të arrirë Ndue Sanaj dhe familja e tij e nderuar, duke pasqyruar realisht, mjeshtërisht dhe profesionalisht jetën reale dhe njerëzit punëtorë, fisnikë dhe bujarë të kësaj treve fisnike dhe të mrekullueshme si Dukagjini, që ka bërë emër në histori.

Janë refleksione plot mbresa dhe emocione të dala nga thellësia e zemrës dhe e shpirtit krijues të autorit, duke bërë përpjekje që të nxjerrim vlerat tona, që duhet të trashëgohen, qoftë nxjerrja e vlerave dhe publikimi i tyre dhe bërja e tyre pjesë e shoqërisë demokratike, e shoqërisë që integrohemi, qoftë në hapësirën shqiptare apo dhe në mjediset e shoqërisë evropiane, amerikane apo gjetkë, gjithkund që bëjmë përpjekje, kudo kemi se çfarë të tregojmë e çfarë të japim dhe të bëhemi pjesë e tyre, me vlerat tona individuale.

Njeriu duhet të bëjë përpjekje të kontribuojë për shoqërinë, bashkësinë ku jeton dhe secili duke kontribuar me

mundësitë e veta jep diçka, që i shërben bashkësisë dhe shoqërisë, që tregon se jemi dikushi në shërbim të vetes, familjes, vendlindjes dhe shoqërisë. - E ky mendim që tregon se jemi dikushi, më ka bërë të vijoj punën time me kënaqësi, të vijoj të punoj për të tjerët, se në këtë mënyrë ndiejmë - 3, Publicistikë, autori i njohur, ushtaraku në karrierë, shkrimtari

dhe publicisti i njohur, dukagjinasi, Ndue Sanaj.

Mendova që këtë publicistikë modeste ta mbledh përsëri e ta vendos në një libër tjetër dhe ta pagëzoj me emrin: "Dukagjini, Shqipëria ime aty" 3. Publicistikë, i cili ndryshon pak nga dy pjesët e tjera, se ka materiale dhe jashtë zonës sonë, sepse në këto dy dekada janë bërë pjesë e pash-

këputur e veprimtarive të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", me realizimin e misionit të saj dhe me kontributin e z. Sanaj si kryetar i saj. Ashtu siç porosit Faik Konica: Shumë duhet të punojmë në shqiptarët, sot dhe për së shpejti, por më parë nga të gjitha: të shëndoshim dashurinë dhe vëllazërinë në mes tonë..." Në qoftë se brezat tanë do ta vlerësojnë sadopak atë që kemi bërë, do ta ndiejmë veten krenarë edhe atje ku do jemi, do ta ndiejmë veten krenarë pasardhësit tanë për punën tonë modeste që kemi bërë në shërbim të Dukagjinit dhe dukagjinaseve, shprehet me modesti, krenari dhe nostalgji, biri krenar i këtyre viseve kreshnike, me histori, kulturë, zakone e tradita, bujari dhe atdhetari, z. Ndue Sanaj, duke sjellë në shenjë respekti dhe vlerësimi, dashurie dhe nostalgjie për vendlindjen e dashur dhe njerëzit e saj fisnikë e punëtorë, një libër të arrirë me artikuj, publicistikë në formë studimesh, analizash dhe opinionesh, duke vijuar të bëjë përpjekje të paraqesë ato mendime, që i duhen më shumë jo vetëm dukagjinaseve të tij dhe të viseve përreth dhe Shqipërisë, duke përcjellë traditat dhe vlerat më të mira, që mbart kjo trevë e bukur dhe kreshnike, me rrënjë të thella në histori, siç është Dukagjini me njerëzit e tij të mrekullueshëm, që u japin jetë në çdo kohë këtyre bjeshkëve mahnitëse.

JAKË RROZHANI



Larg duart nga ligjet e natyrës!



LEKË IMERAJ
shkrimtar, përkthyes,
publicist

Në disa vende të BE-së (Bashkimit Evropian) dhe në botë, po diskutohet për ligjin e vetëvendosjes së gjinisë. Madje është bërë gati projektligji. Në Gjermani mendohet të hyjë në fuqi me dt. 01.11.2024.

Sipas ligjit, adoleshentët, ndër të tjera, kur mbushin moshën 14 vjeç, kanë të drejtë të vendosin vetë për gjininë e tyre. Djemtë mund të mbajnë gjininë e tyre biologjike ose, mund të vetëdeklarohen vajza. Kështu është edhe për vajzat. Secili mund të zgjedhë vetë prirjet e veta seksuale (homoseksual, heteroseksual, biseksual, transseksual e të tjera). Fjala "nënë" dhe "baba", hiqen nga përdorimi. Në vend të tyre do të përdoren fjalët "prind-1" dhe "prind-2".

Meshkujt e vetëdeklaruar femra, mund të futen në të gjitha sferat ku, deri tani, kanë qenë vetëm për gra. Një qenie njerëzore, me mustaqe, mjekër dhe penis, mund të futet në banjën e grave, në sauna ku gratë janë lakuriq dhe, kudo.

Me këtë ligj, merr fund "persekutimi" i meshkujve. Nëse dikush guxon t'i qortojë, ndëshkohet me 10 mijë euro gjobë dhe, padi penale.

Shumë analistë, psikologë, filozofë, antropologë, biologë e mendojnë ndërhyrje në programimin natyror të njeriut, degjenerim, rrezik për identitetin dhe jetën e njeriut. Ata bëjnë thirrje: Larg duart nga

ligjet e natyrës!

Mashkulli dhe femra, jo vetëm fizikisht por, edhe psikikisht janë programuar nga natyre komplet ndryshe nga njëri-tjetri.

Ja një shembull i cili, tregon se, çfarë do të thotë të mundohesh të ndryshosh pushtetin e natyrës tek njeriu. Tregimi bën fjalë për një djalë nga Kanadaja.

Djali quhet Bruce Reimer. Bruce u detyrua nga prindit të rritej si vajzë, por përfundoi në mënyrë tragjike.

Si ndodhi?

Bruce erdhi në këtë botë në vitin 1966, binjak, bashkë me vëllain e tij Brian. Pas shtatë muajsh, kur gjithçka shkonte për mrekulli, nga operacioni i synetllëkut, filloi tragjedia e jetës së tij. Penisi i Bruce u dëmtua aq shumë, sa nuk mund të riparohet më. Dëshpërimi i prindërve ishte i pazakontë.

Ata muarën kontakt menjëherë me psikologun dhe hulumtuesin seksual, John Money.

Money mbronte teorinë e vetëvendosjes së gjinisë. Sipas tij, gjinia e njeriut nuk është e programuar biologjikisht por, është punë edukimi në jetë. Secili mund t'a zgjedhë vetë gjininë e vet. Prandaj ai ju rekomandoi prindërve ndërtrimin e gjinisë së djalit. Dhe ashtu u vendos.

Bruce ia hoqën testikulat, filluan ta mjekonin me hormone femërore, e veshën me fustan, dhe me kaq menduan se ia arritën qëllimit. Bruce nuk duhej ta mësonte kurrë atë që i kishte ndodhur.

Bruce u rrit dhe hyri në moshën e pubertetit. Ia shtonin dozën e hormoneve femërore, dhe si rrjedhojë, iu zhvillua


gjoksi.

Kur mjekët vendosën që t'i bënin vajzine artificiale, ai kundërshtoi.

Bruce e kishte kuptuar me kohë, që diçka, nuk shkonte me trupin dhe mendjen e tij. Sa më shumë që rritej, aq më shumë ndërjegjësohej për atë që nuk shkonte. Kjo e revoltonte shumë. Griste fustanet, urinonte në këmbë, dhe ndeshej me djemtë. E urrente trupin e vet, pa e ditur përse.

Prindit e dërgonin vazhdimisht tek psikiatri për mjekim. Familja e kishte humbur qetësinë dhe sigurinë, megjithatë shpresonin tek mjeku psikiatër.

Ata vuanin bashkë me djalin e tyre, por përsëri nuk merrnin guxim t'ia thonin të vërtetën.



djali Bruce Reimer

As fustanet e pruarë, as hormonet e pafundme, nuk po e bënin Bruce vajzë.

Jeta dhe sjellja e tij bëheshin gjithnjë e më të komplikuar.

Nga që, askush nuk ishte në gjendje të thoshte, se çfarë duhej bërë më tej, vendosen t'i tregonin të vërtetën.

Në këtë moment, Bruce kishte mbushur 14 vjet.

Ai, kur mësoi të vërtetën, kaloi në fazën e çmendurisë së plotë. Nuk mbahej. Pas një mjekimi intensiv, u rikthye në gjendje arsyetimi.

Por, si arsyetoi Bruce!

E para gjë që bëri, i vuri flakën dollapit të rrobave. Fustanet e tij firmato, u bënë shkrimb e hi. U vesh si djalë dhe filloi të sillej si mashkull. Ia vuri vetes emrin David. Programi i tij nuk kishte mbaruar.

Iu drejtua kirurgut për të hequr gjoksin femërorë dhe vendosur penis. Ai e ndjente veten mashkull dhe donte të kompletohej si i tillë.

Në moshën 32 vjeç u martua, dhe gjashtë vjet më vonë, bëri vetëvrasje.

Torturat shpirtërore dhe fizike, hormonet femërore dhe sjelljet e detyruar, jashtë natyrës së vet, e kishin lodhur dhe rrënuar atë. Ai ishte terrorizuar vite me radhë psikikisht, nga që nuk kishte guxuar të ishte ai që e kishte programuar natyra. Nuk mundi më.

Jo vetëm kaq. I vëllai i tij binjak, Brian, kishte përjetuar me shumë dhimbje eksperimentet mbi vëllain e vet. Nga që nuk mundi t'i duronte më ato eksperimente shtazore, bëri vetëvrasje, dy vjet para se Bruce të bënte të njëjtën gjë.

Nëse gjithkush bën ato që ka në pushtetin e vet, bën boll. Larg duart nga pushteti i natyrës!

Një kujtesë për Dom Tedin në një vjetorin e ndarjes nga jeta, meshtari i pare i krahinës së Shalës në vite e para të demokracisë

Rënia e sistemit komunist solli dhe lirin fetare. Në vitin 1993, në krahinën e Shalës vjen një misionar nga Amerika Dom Tedi.



Edhe pse kane kaluar 30 vite njerëzit nuk harrojnë këtë meshtarë "të çuditshëm", për popullin. Kishin njohur meshtarë, të cilët qëndronin vetëm në kisha. Ky, ishte meshtari, që udhëtonte çdo ditë në këmbë në çdo fshat e lagje të Shalës, natën e ditën i shoqëruar e i pa shoqëruar nga vendësit. U ndesh me varfërinë e tej skajshme e me "cuba" mali që lëviznin nga një vend në tjetër vend. Ishte shumë sportive dhe kishte përgatitje të larte për karate, nuk hezitonte të ndeshje edhe trup me trup me keqbërës. Kush ishte Dom Tedi?

Théodore R. Hchstatter lindur me 6 gusht 1949 në Mendora, Islande dhe ka vdekur me 21 Shtator 2022, në Dunlap, Illinois, SHBA. Studimet e larta për teologji i kishte mbaruar në Universitetin e Çikago. Jeta e tij misionare në shumë vende të botës e beri mjaftë të njohur.

Me 20 korrik 1993 mbërrin në Romë si vëlla i misionit të Nene Terezës dhe me 20 korrik 1993 vendoset në Shqipëri në krahinën e Shalës.

Dom Tedi punoj ditë e nate për ngritjen e strukturave të kishave që ishin te rrënuara si dhe një lufte për varfërinë e skajshme.

Në vitin 1995 u prite në një vizite private nga Papa Gjon Pali. Ndërtoj Kishën Shën Gjoni në Breg Lumi dhe punoj për vënie në funksion të kishave të tjera. Ndhimoj me mjete didaktike, libra, fletore e të tjera për shkollën e mesme Breg Lumi dhe mjete për Spitalin.

Ndërtoj një shtëpi misionare për motrat e Nenë Terezës.

Në çdo fshat shkonte duke shërbyer në përhapjen e fjalës së Zotit. U ndesh me grupe kriminale të rrezikshme, që e qua-

nin veten "cuba", deri në ndeshje fizike, duke quajtur prifti karate.

Punoi deri në vitin 2001 në Korçe, për të mbërritur në Afrikë.

Puna e tij është mjaftë e madhe për ngritjen e kishës në krahinën e Shalës. Në varrezat e kishës së Shën Pali e Shën Pjetri, në Peterstown, ku u zhvillua ceremonia mortore mbërrin një letër falënderim e kurora me lule në emër të krahinës së Shalës nënshkruar nga ish Kryetari i kësaj komune, z. Ded Prendaj, sot me banim në SH.B.A.

Faleminderit për kontributin e dhanë për Kishën Katolike në krahinën e Shalës!

Përgatiti:
Zef Nika, Bruksel

ZEF MARK ZEKA DO NA MUNGOSH NË BISEDË, POLEMIKA ZENKA DHE SHPOTI



Kishte guxim dhe energji të matej me shekullin, por dje u rrezua në xhiron fundore i përfaquar nga një vdekje e bekuar pa vuajtur as një gjysmë ore.

Zef Mark Zeka qe një personazh kundruar jetës shoqërore të Dukagjinit, për më se pesë dekada. Autodidakt i këndueshëm, natarë i spikatur kundra rrjedhave, polemist i rafinuar, shigjetare idhnak, re që mbillte acare e stuhi, por që krejt pa prituri zvarritej dhe dhuronte ngrohtësi e rrema të hollë shpotie e gazetarie. I shumë shëtitur, i tundur të debatonte me ambiente

intelektuale e kulturore. I pa përtuar të ndërmerrete ofensiva teje të vështira pa pyetur për tabutë apo brirët e demit sundues. Pati një rreth fisnore të sferave të larta intelektuale si familjen e Gjon e Lec Shllakut, Arqipeshkvin Dioqezës Pultit Bebardin Shllakun, Robet Ashtën, Profesor Tonin Fistanit e me familjen Mark Thanit; pati njohje dhe kujtime mbresëlënëse me At Frano Kirin, At Pjetër Meshallën, At Zef Pëllumbin prej të cilëve mblodhi bash diturie, huazoj, "vulli" libra dhe literature të ndaluar në pjacën e kohës monistë.

Zef Mark Zeka pa universitet nuk shkoj "hise shkret" si shumë universitare që me diploma të kadifenjta morën vende pune të rehatshme, por nuk lanë as gjë të shkruar pas. "Një shekull për Pultin", është kryefjala e jetës së tij në shërbim të promovimit të historisë dhe kulturës Pualike-Dukagjinase.

Zef Mark Zeka i beri vend vetes, duke zbrapsur bërnylat dhe hijet e renda të studiuësve fuqi plote.

Zef Mark Zeka hyn nder ata shkruer dhe kryesisht mbledhës e ruajtës fanatik të dokumentacionit, që aq shumë anashkalohet, lihet në pluhur dhe shtrembërohet e keqinterpretohet. Njohës i mirë i folklorit, etnografisë dhe historisë së Dukagjinit, por për krejt vlerat njerëzore dhe identitetit historik të trashëgimisë sonë kombëtare. Mos tu vinë çudi atyre, që nuk e dine se, Zefi ka bashkëpunuar me Institutin e Historisë, të Etnografisë me qendrën e studimeve Albanologjike,

me Muzeun Historik Kombëtare dhe TV Shqiptare për dokumentare dhe emisione të kulturës dhe historisë.

Organizata Ndërkombëtare për Shkrimtarë P.E.N. Albania i ka akorduar çmimin për kontributin e pasurisë kombëtare së kishës së Pogut.

Drejtori i Muzeut Kombëtarë Dr. Dorian Koçi shkruan se, Zef Mark Zeka u bë gardian gjate kësaj kohe për ruajtjen kësaj trashëgimie e që vjen nga thellësia e shekujve...(Ndoc Selimi "Pulti Burim i rrjedhave historike", Shkodër 2022, fq. 138).

Zef Mark Zeka është bashkautor i librit disa vëllimesh në vargje "Eposi i Shqipeve" jug e veri, është konsulent i librit të studiuesit dhe publicistit Ndoc Selimi "Pulti Burim i rrjedhave historike".

Zefi ka bashkëpunuar me disa gazeta dhe revista, duke ju dhuruar vijimisht brumë të pasur nga litologjia e vendlindjes së tij.

Besimtare i devotshëm antikomunist, antikonformist, antimegaloman ndaj të ashtu quajturve bajraqe pallë-sundues demokrat i zhgënjyer thellë syzues, i pa mëshirshëm po gabove apo nuk i pëlqeve nder shkrime, pati shumë kundërshtarë, por edhe shumë miq kryesisht në radhën e sferave intelektuale dhe më të rinjve se vetja.

Shllaku, Pulti dhe Shoshi ishin trekëndëshi më i adhuruar i jetës së tij të potershme, gjithashtu debulesë kishte edhe për Malësinë e Madhe, që pallë zhve-

shur ndaj shaljaneve e hotjanve prepotent. Kritik here i ashpër, por edhe dashmire i gazetës "Dukagjini", të cilën numër pas numerik e mbajti në xhep, në tavolinë, në koleksion, polemizoi ashpër dhe deshi fort si më e madhja arritje kulturore rajonale pasi ndiqte me vëmendje çdo gjë që shkruhej për Dukagjinin.

Mbështetur në kujtimet At Frano Kirit, Zef Mark Zeka konfirmon një fakti të rëndësishëm historik djegien, shkatërrimin edhe arratinë pa kthim të pjesë më të madhe të popullsisë së krahinës së Shoshit, në kohën e ekspeditave pushtues Stefan Dushani të Serbisë, kemi debatuar deri në mos përputhje, disa herë më ka kritikuar me hakërrim, por vijimisht më ka respektuar.

Kam qarë, duke lexuar novelën tende "Marsh Tucin ndorja shqiptare" dhe betohej, duke më thënë se, ja kam lexuar edhe gruas e familjes, por ti nuk e din as vete çfarë ke shkruar! Më ka ftuar disa here kohet e fundi të pimë kafe dhe bisedonim për disa tematika dhe dokumente që dispononte. Puna ime lak shkurtër nuk më lejoi, ndërsa Zefi nuk e mbajti fjalën dhe u largua pa prite, por jo pa prituri se ishte 88 vjeç, por fat lum.

Pushofsh në paqe, por do na mungosh në biseda, polemika zënka dhe shpoti!

PRELË MILANI

Një periudhe pune e madhe ku mësova dhe u përkushtova shumë pas profesionit në një ndërmarrje të madhe. Unë krijova familje në Fushë-Arrëz, në vitin 1978 u martova me Irenën (me origjinë nga Shkodra) teknologe në Fabrikën e Kollofonit. Në vitin 1990 lindi djali i parë Orioni. Tashmë nga Fushë-Arrezi do largohej veti i treti, një familje e vogël, e cila po kërkonte një jetë më të mirë.

Në vitet 1992-1993, në përpjekje e fundit për tu kthyer në Shkodër. U krijua mundësia, që të emërohem mësues në Shkollën e Mesme Pyjor Shkodër, kishin dale mësues në pension, unë plotësoja të gjitha kërkesat, kisha mesatare të larte, stazh dhe përvoja pune, një njohje dhe dashamirësi e drejtorit të shkollës Zef Shpori, që të isha në grupin pedagogjik. Por nuk qe e mundur një drejtor arsimit në Shkodër në atë kohë një Besnik...i tha Zef Shporit, që ky zotëria mund të vije pedagog tek shkolla juaj, nëse nuk ka dëshmi si i persekutuar apo të ketë rekomandim nga PD e Shkodrës. Unë nuk kisha dhe nuk bëra asnjë përpjekje për këto letra dhe pse ndoshta më kushtoj shumë. Unë dhe Zefi i vumë përpara shëf Besnikut diplomën, listën e notave, vlerësimin e punës nga NPD, një vlerësim me goje i beri Zefi për mua dhe i tha se, ishte gati ta bënte me shkrim çdo kërkesë, madje deri në Tiranë në Ministri, por Besniku i meruar i PD-së me rebelizëm na nxori jashtë mua dhe drejtor Zefin. Ai tha ky nuk do vije tek ajo shkollë dhe pike, do sjellim një të persekutuar... Në fakt si "persekutuar" aty u emërua një inxhinier pyjesh pa mesataren, po person që i gjeti mik një kryetare të Komitetit të quajtur Terezina.... Ai punoi një vit dhe braktisi atë pune. U shua dhe kjo shprese e fundit dhe një ëndërr për tu bërë mësues në Shkodër. Edhe këtu, sipas meje vijonte ai diskriminimi i fshehur, për ne dukagjinasi katolik dhe pse kishte ndryshuar goja sistemi pas 90-tës...

Nuk u ktheva dot në Shkodër, mësyna drejt Lezhës. Në vitet 1993-1998, punoj inxhinier dhe Shëf i Seksionit Teknik në Drejtorinë e Shërbimit Lezhë. Në një punë tërësisht ndryshe nga ajo në NPD Fushë-Arrëz. Ndryshimi i sistemit po sillte ndryshme dhe në qeverisjen e pyjeve, ato filluan të dëmtohen, diku filluan të zaptoheshin si prona private, e të tjera. Në vitin 1996 një projekt i mbështetur nga qeveria amerikane nëpërmjet USAID kërkon të mbështesë DSHP Lezhë, për transferimin e pyjeve në Komuna. Një proces i ri me shumë probleme, por Lezha do shërbente si rreth pilot. Ata kërkuan një specialist të punonin me ta në terren. Drejtori Fadil Kraja, caktoj Gjonin me këtë detyrë. Në vitin 1988 me mbështetjen e USAID-it me specialistin Prof. Dr. Vezir Muharremaj; si Projekt Pilot, ka kryer transferimin dhe hartimin e Projektit të menaxhimit të pyjeve në komunën Blinisht - Lezhë, projekti i parë i këtij lloji në Shqipëri. (Për këtë veprimtari dhe atë botuese, është i përfshirë në botimin për personalitet "Leksioni i Lezhës", Kujtim Dashi 2010).

Tek vazhdon rrëfimin e tij Gjoni thotë:

"Puna ne këtë projekt të "Pylltarisë private", përvoja që fitova, rezultate që arrita ambicia profesionale më shtynë të mendoj për punën drejt Tiranës. Në mar-

rëveshje me Projektin e Pylltarisë Private u dakortësuam që unë të vija në Tiranë, diku në një institucion të nivelit të larte. Në vitet 1998-1999, u emërova punonjës shkencor në Sektorin e Silvikulturës në Institutin e Kërkimeve Pyjore dhe Kullotave, Tiranë".

Tashme nga Lezha drejt Tiranës do ishim katër veta, ishim shtuar dhe me Ermalin-lezhjan, një familje më e plote. Po ku do shkonim, ku do strehoheshim. Një histori vajtjesh kjo pasi mundësia për të blere shtëpi nuk ekzistonte. Në shtëpia me qira dhe në konviktet e qytetit Studentit jetova shume vite, prej aty u shkolluan djemtë dhe ne si familje me shumë përpjekje e sakrifica mbijetua.

Tek kthehem tek kronika e punësimit dhe pasurimi i jetëshkrimit në profesion kthehem tek Projekti i Pylltarisë private tashmë si specialist i tij në qendër. Në vitet

në tre projekte ndërkombëtare. Konkurova për përgjegjës sektori në DPPK. Në muajin qershor 2004 - janar 2006, punova Përgjegjës i Sektorit i Silvikulturës dhe Burimeve Pyjore, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Pyjor (DPSHP).

Pa u shkëputur nga puna, në periudhën 2006-2010, Gjoni vijon Shkollën pasuniversitare në Fakultetin e Shkencave Pyjore, duke mbrojtur titullin Master shkencor i barasvlershëm me doktor.

Gjoni në rrëfimin e tij done të regjistroje disa probleme dhe episode të jetuara, që kanë sjelle një prapambetje të shoqërisë shqiptare, në periudhën pas komunizmit.


Në vitin 2005, Drejtorja e Përgjithshme të Shërbimit Pyjor, (DPSHP) do bashkohej me Ministrinë e Mjedisit, Administrimit të Pyjeve dhe Ujërave (pazari i Xhuvelit me Berishën, që shkatërruan in-

mund të linin dhe pa asnjë emërim dhe ti le të mbetesh në gjyq, por për ty kam dëgjuar fjale të mira si specialist dhe kaq mund të bëjmë", më thotë Ministri. Kjo ishte politika që ndiqej jo vetëm me mua, por me të gjithë ata që nuk ishin partiak apo të lidhur me partitë në qeverisje. I nënvizoj këto fakte për të treguar realisht, duke mbete të shkruara se një nder problemet e mëdha që çoj në një prapambetje 30 vjeçare në tranzicion të Shqipërisë, është shpërdorimi deri në shkatërrim të burimeve njerëzore dhe intelektuale të këtij vendi.

Pas largimit nga ministria, çfarë duhet të beja? Të bridhja në gjykata, të merrja kredi për të paguar avokat e gjyqtar apo të shkoje tek ai vend i ofruar. Si gjithmonë joshesha pas profesionit, kujtoja shkolimin dhe sakrificat për të?! Shkova tek puna në Drejtorja e shërbimit pyjor, Tiranë.

Në mars 2010 - shkurt 2014 me shkëputje tre muaj, punova Shëf i Seksionit Teknik dhe Ekstensionit në DSHP Tiranë. Nuk kam çfarë të kujtoj për mirë se, pyjet po merrnin rrokullimën, kërkoheshin ngastra për shfrytëzim, sipërfaqe në përdorim, leje për gurore, e të tjera, e të tjera. Sapo shkela në DSHP Tiranë, madje në sy të drejtorit të kohës me "Përmbledhjen e ligjeve të pyjeve" në duar të botuar nga unë, bërë një betim, që e mbajta: "Nuk do veprojmë në asnjë rast dhe nuk do ketë njeri që do të me detyroje të firmosi aty ku unë mendoj se shkelet ligji dhe pylli dëmtohet, kjo dhe nëse do të më largonin nga puna". Në kohën dhe mjedisin që jetojmë (me korrupsion e shpërdorime pafund) ishte një kokëfortësi me pasoja, që tek ne malësorët shfaqet shpesh për mungesë "elasticiteti". Në fakt kështu ndodhi, behet shkas, kërkohet që një ngastër pyjore me një volum të madh për dru zjarri nga zona e Berzhites dhe Karabes, duhej ti jepej një personi që kishte sjellë kryetari i komunës Gëzimi....., ky sipas tyre do mbështeste fushatën e republikanëve të Mediu, në vitin 2013. Refuzova hapur të firmos e të kryej veprimet, për atë ngastër, pas tre ditësh, në maj 2013 vjen urdhri i pushimit nga puna me motivacion: "Për pengim të reformës në pyje dhe mos bashkëpunim me pushtetin vendor", i firmosur nga ministri Mediu. Ky është fakt tjetër si veprojnë partitë politike në pushtet me pasuritë natyrore, një fakt që tregon se si janë shkatërruar pyjet, për të cilat me dhemb shpirti mua dhe shumë specialistëve të ndershëm e të përkushtuar të pyjeve. Kështu me këto pazare veprohej kudo ku kishte pyje dhe pasuri të tjera natyrore.

Sa vazhdoj fushata elektorale e atij viti deri në shtatorin e vitit 2013, kur Mediu dhe PD humben, unë mbeta rrugëve duke dërguar letra dhe ankesa tek Avokati i Popullit, Komisioneri kundër diskriminimit, tek shërbimi Civil, e të tjera, hapa një gjyq. Ishte kjo periudhe ku unë pashë si funksiononin këto struktura dhe sa arrinin të zgjidhnin problemet. "Mos o Zot më keq" thoshin të vjetrit tonë dikur. Mblodha fakte dhe u përqendrova tek "Komisioneri kundër diskriminimit", duke quajtur largimin tim nga puna për arsye të pastra të bindjeve politike, ata shqyrtuan çështjen, nxorën vendimin që të kthehesha në punë aty ku isha, në



Botimet kryesore si autor dhe bashkautor "Rrëfime në tetor", 2022

1999 - 2001, Konsulent lokal për Komponentin e pyjeve komunal në Projektin e Pylltarisë Private (APFDP) "Cemonix IC" financuar nga USAID-USA

Në vitet 2001 - 2002, Konsulent lokal, për regjistrimin e pyjeve në "Projektin e regjistrimit të pasurive të paluajtshme"

Në vitet 2002 - 2004, Konsulent për Informimin dhe Ndërgjegjësimin Publik "Projekti Shqiptar i Pyjeve" i financuar nga Banka Botërore. Këto projekte u mbyllën. Kisha shumë përvoja, kisha një CV-i nder më të mirat midis bashkëkohësve inxhinier pyjesh: konsulent

stitucionin më shumë pasoja, në shkatërrimin e pyjeve dhe administratës pyjore). Në periudhën janar 2006 - shkurt 2010, punova Specialist i trajtimit të resurseve pyjore në Ministri. Në ministri kishte shumë rryma e pëlqime partiake që lidheshin me klane dhe ministrat përkatës. Ministër Fatmir Mediu, pa asnjë arsye objektive (por se nuk isha republikan as anëtar i PD ose pjese e kalimeve të tyre), më transferon, më çvleftëson dhe statusin e nëpunësit civil (të fituar me provime), duke më emëruar në Drejtorinë e shërbimit pyjor Tiranë. "Na dijë për nder se

Shkolla “Nënë Tereza”

Ditën e shtune, me datën 21 tetor 2023, Shoqata “Vëllazëria Shqiptare”, në Montevarchi Arezzo, beri takimin me mësuesit e shkollës Shqipe, për të organizuar programin mësimor dhe për të vendosur emrin e shkollës, për të cilën gjithë ishin dakord, të vendoset Sholla Shqipe dhe të pagëzohet me emrin “Nënë Tereza”. Urojme që shkolla Shqipe “Nënë Tereza”, në Montevarchi Arezzo të ketë suksese.



drejtorin e DSHP Tiranë (punëdhënësin tim) ta gjobitnin me 500 mije lek pasi ky i kishte “propozuar” ministrit largimin tim nga puna. Ai drejtor dhe pse kishte bere “propozimin” nuk më kishte njohur kush isha, që doli në ballafaqim se tre dite kishte që ishte emëruar drejtor. Edhe pse kisha të tillë vendim, me shumë ndikoj rrotacioni politik në rikthimin tim në punë. Mediu të humbur si ministër “ju vardisa nga pas” çdo ditë tek zyra dhe në rrugë, “Ju e humbet pushtetin i thashë me kthe në punë se, më keni larguar nga puna në shkelle të hapur të çdo ligji”. Ai e dinte mirë këtë, beri urdhrin, ma dha në dorë dhe unë u riktheva atyre ku e lashë pas 4 muaj rrugëve.

Ndërrimi i ministrave dhe i kabineteve mua me gjeti në punë. Në çantë mbaja të printuara tre palë dokumente dhe do i dërgoja kudo ku kishte gjoja vend të lirë në Ministri apo Agjenci për inxhinier pyjesh, do konkurroja, kisha dosjen më të mirë nga gjithë koleget. Konkurrova në tre vende, në Ministrinë e Mjedisit “tashme prone e LSI” listohesha në treshe dhe nuk më s’kualifikonin dot, sipas ligjit të kohës ministri zgjidhte njeri nga treshja pavarësisht pikëve. Asnjëherë ministri Koka nuk më zgjodhi mua dhe specialist sektori pyjesh zgjedh një inxhinier mjedis, përgjegjës sektori në kadastrën pyjore zgjedh një jurist dhe në një pozicion tjetër zgjedh një agronom. Unë përgatisha që përveçse konkurrimin me shkrim do prezantoja gjoja tek ministri platformën për pozicionin e listuar. Ministri këtë

ja delegonte drejtoreshë si procedure se, ai i kishte vendosur paraprakisht personin tek vendi, ne të tjerët kot mundoheshim. Tek u paraqita për të tretën here tek drejtor Pëllumbi, me platformën në dorë, për ta lexuar e diskutuar si do të beje punën, nga njohja e vjetër me tha: “Lëri nuk ka nevojë të më lexosh as të thuash asgjë. Ti je budalla apo nuk e kupton që ministri nuk done të marre ty në asnjë pozicion. Pse humbet kohen përpiku diku tjetër, se në Ministri nuk mund të kthehesh më”. Edhe këta të LSI kishin të njëjtën praktikë si republikanet, por me të kamufluar në veprime. Ashtu bëra. Në muajin shkurt, 2014 konkurrova dhe si specialist fillova punë në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit. Nuk ishte pozicion, që kishte page dhe privilegje prandaj nuk kishte kërkesa nga anëtarë të LSI. Këtu punova deri shtatorin 2020 kur u krijua Agjencia Kombëtare e Pyjeve. Edhe këtu nuk hapen asnjë vend për konkurrim që unë të mund konkurroja për pozicion më të lartë. U sollën si shefa sektorësh dhe drejtoreshë shumti jashtë profesionit të inxhinierit të pyjeve gjoja me lëvizje paralele. Unë, nuk mund të ngrihesha në detyrë shef sektori nëse ky vend plotësohej me lëvizje paralele. Edhe kjo model qeverisje si vijimësi e të parave në trajtimin e burimeve njerëzore. Ato çfarë shkruhet në letra për shërbimin civil dhe burimet njerëzore është mashtrim i madh.

Unë mendoj se nëse nuk je pjesë dhe ti shërbesh një klani në pushtet nuk mund të marrësh pozicionin që meriton pavarë-

sisht sa di dhe sa vlera njerëzore ke. Nëse je specialist i zoti e korrekt në punë, madje rrinë i mënjano dhe “nuk përzihesh” në rastin e mirë arrijnë të ruash një pozicion si specialist i thjeshtë siç jam unë, prej vitit 2006, kjo dhe në rastet kur drejtuesin e ke të një profesioni dhe njehadopak çfarë di të besh dhe kjo Drejtori partiak në institucionet, që nga profesioni nuk kanë asnjë ide, i marrin në qafë të gjithë profesionistët e vërtetë, kështu vijon prej 30 vitesh kjo histori.

Vitet kaluan dhe nga 5 qershori 2022, ka mbushur moshën për pension, por vijon të punoj në Agjencinë Kombëtare të Pyjeve me të njëjtën ritëm, disiplinë dhe përkushtim sikur jam në moshë aktive. Është pasioni për pyjet dhe përkushtimi për të bërë diçka të mirë, pavarësisht sa ajo ndikon në tërësi e problemeve që kanë pyjet sot.

Në vend të përfundimeve.

Edhe këto rrëfime personale shkurt përveçse një kronologji e jetës time modeste që ndoshta nuk ka nevojë të dihen nga lexuesit, por kanë një qëllim tjetër, për lexuesit e sotëm apo të nesërm, që në kaq pak radhë dhe episodet të jetuara, të shohin si dhe sa keq funksionuan gjerat dhe proceset pas viteve 90.

Tek sheh librezën time të punës të hapur në Ndërmarrjen pyjore Shkodër 6 shtator 1976 dhe deri në vitin 2022 janë më shumë se 46 vite ku prej tyre në katër vite kam qenë student, të tjerat lidhen direkt me punën si pylltar në nivele dhe institucione të ndryshme. E përmbledhur

me luhatjet e saja jeta ime profesionale mund të quhet ; **“Një jetë me pyjet në një Shqipëri sot gati pa pyje”.**

Në jetën familjare modeste ndjehem i plotësuar dhe i lumtur me bashkëshorten Irenën dhe dy djemtë e mi tashme të rritur, me shkollim të lartë dhe punësuar jashtë Shqipërisë. Ata janë larg nesh kur ne do ti donim pranë dhe kjo është dhimbje për ne, por ndërkohë jemi të kënaqur se atje e kane gjetur veten si profesionist. Sa shohin e dëgjojnë janë disi të zhgënjyer për realitetin e sotëm shqiptar dhe nuk ndjehen të motivuar për kthim. Si pjese te familjes pak më të madhe unë kam një nip dhe katër mbesa dhe këto me shkollim të lartë, në dege të mira e të pëlqyera prej tyre. Të gjithë punojnë në ndërmarrje dhe institucione private, brenda dhe jashtë vendit, një zgjedhje e tyre por dhe një rekomandim imi që në krye të herës, të mos ëndërronin të punësohen në administratën shtetërore të këtyre 30 viteve tranzicion.

Ju duhet të mësoni të bëheni të ditur në profesion sa dikush të ketë nevojë tu “blejë” mendjen tuaj. Kjo këshillë e imja; me punën pasioni dhe vullnetin i tyre ka gjetë zbatim të plotë. Të shtatë sot janë të shkolluar dhe me synime që të behën dikush në jetë. Kjo është ajo që më lumturon më bën krenare dhe kam me se të “mburrem në këtë jetë”

**Rrefime në tetor, 2022
posaçërisht me Ndue Sanaj**

*** POEZI nga Tahir Bezhani *** POEZI nga Sibela Bala ***

**TE UJËVARA**

Ndala mu aty
Përballë saj ngulita shikimin në kohë
Kujtimet ndezën zjarrin e viteve të shkuara
Sa më rrëmbeu malli thellësive
Shikoja silueta të ngrira përfaqimeve
Ngjyra ylberi lëviznin n' shikime
Perceptim gacash të ndezura në shuarje
E ujëvara shushuriste vajtueshëm
Si fjalët e saj në ndarje dikur...

Rrëshqasin degëzimeve të zemrës n' vuajtje
Vallë a i lan hëna sytë natën në këtë ujëvarë
Një pyetje naive në buzëqeshje të zhurit
Rrëshqet buzëve si heshtja e lënduar
Si zë i lëmekur tingëllimave
E shikoj ujëvarën pa nda në thellësi
Loton, zhurmon, dënese gjithmonë
E shkruar...

QETËSI QË TË THER...

(Motiv bjeshkor)

Sytë shëtisin shpateve
Shpirti dehet n' bukuri lulnajash
N' ushtimë gurrash e prrojesh
Bukuri e rrallë
Qetësia e ikur n' hapësirë
Shprush mallin e rrokotelur gurnajës
Nuk di ku mbeti melodia e fyellit
As kënga e vashave
Nuk dëgjohet blegërimë e qingjeve ograjave
Nuk ia thotë askush këngës majëkrahut
Barinjët nuk ia ndërrojnë gishtat vrimave të fyellit
Ajo melodi trazuese e shpirtit...

Kah rrëshqasin gëzimet rrënojave
Si gur i harruar buzë rruge
E bjeshka do gjallëri,
Sgacë pranë gurrave
Aty ku shkëmben zjarrshikimet
Kur vajzat mbushin bucelat me uji
Gjaku lëvizë si ujëvarë rrëmbyeshëm
E puthjet fshehën, mrizojnë pishave....


Sa vrastare ajo qetësi bjeshkënjës
Ku vajti gjithë ai zjarr
Ajo rini ku iki
Ka ngrirë koha,
Fyrlave të heshtura malli
Qetësi që të Burgos shpirtin
Të ther palcën....

TERRINË

Natën vonë,
Hapa dritaren e dhomës
Terrinë nate e zezë
Hëna kishte ikur përtej majave
Mjegulla ua kishte zënë rrugëtimin yjeve
Vetëm sytë e mi ndrinin si xixëllonja n' rrugëtim
Mbeta i përthurrur mëdyshjeve intime
"A frymon gjallesë mbi këtë tokë?..."
Phiiii a!..
Klithmova në mesnatë
Më dukej vetja si në ëndërr
Ngjasonte kjo natë
Sikur udhëtoja përrallave me fantazi fëminore
U pajtova edhe me sylotimin tim
Rrugëtimeve të hutuara natën....

FRYMËZIM ÇASTI

I shikoj, më shikojnë
Më përkëdhelin e miklojnë
Si shpirtëzim klithmash ngashëruese
Vendnumërojnë këmbët, hijeve pushojnë
Retë e mbarsura me riga shiu lodrojnë
Lajnë mallin flokëbardhë në prozhme
Shikohem me pishat e larta aromatike
Më ngulfat bukuria, aroma e rrëshirës
Lodhja ikën luginave n' përfaqim të freskisë
Në krahëror ushton lum jete
Dëshirat mallojnë shpateve
Bardhësia e veshur kokës
Pajton rini e pleqëri stinimeve
Në këtë thelbbjetë të ndrydhur...

Bogë, 18, 19 Shtator 2023**NJË NATË PA HËNË**

Moti kanë shtegtua zogjtë
Janë lodhure edhe pulëbardhat në fluturim mbi ujë
Në netët pa yje e pa hënë
Është si një trup i huaji
Pa emër e pa kufi ..

Edhe liqenet kanë heshture
Në errësirën e një nate si kjo
Asnjë dritë nuk reflekton mbi tokë
Koha ka marrë një nurë zbrastie e shumë të ftohtë
E ashpër nata e errët në këtë botë ..

Të gjithë në këto netësh pa hënë
E ruajnë një frikë trishtake
Përrulen njerëzimi si të mekure
Sikur të ishte e gjithë bota e vdekure
Një natë e ftohtë
si kjo
Vendin nga jehona e ka zhveshure
Dhe cilësohet si natë e -pa fate.,,

Asnjë poçe llambarie nuk bënë dritë më
As nga pazari i vjetët
Zogjtë e malit kanë shtegtua prej shumë ditësh një vend
tjetër

Çdo gjë në një natë të erret si kjo është e trishtë
E jepe një aromë të zbehtë si gjysmë- vdekure ..

KUSURIN TEND MERRE

Mos mendo se jeta rregullon çdo gjë
Ajo vetëm hapë udhë e shtegtime çfarë ti se paramendon
Fishkëllon si gjama në detë
Kurë ti je më mirë se kurrë
Atëherë qetësia në ankthe triumfon ..

Qëndro i palëkundure
E mos u bë mëkatarë
Kusurin e të jetuarit në jetën tënde
Mos e keqpërdore për pazare
Jeto i dejtë mos u bë zullumqare.,

Kjo jetë dinë të përqafojë e të të kërcënojë
Ngadalë mësohu me dëgjua e me fole
Mos u the si poçe balte para kohe
Merre kusurin e jetës që të takon nga kjo botë ..

NJË VELLO MYSTERI

Të gjithë mundohen të ta shpajnë syrin me djallëzi
Mos u bë gojë memec o njeri
Në vello misteri mos u mbulo në zi ..

Ajo vello misteri përmban shumë pabesi
Në gjokse mos mbani mëri
Se kjo ngjyrë e asaj velloje misteriozë
Ka veshure miliona njerëz në zi ..

Në hapësirën e një dritëze merre guxim
E fronin e jetës veje në zbatim
Me Dij' e Shkencë mos u mburrë si huaj
Se misteri i asaj velloje të zbehe të mbulon edhe ty ..

Mos mendo se kjo botë shkëlqen gjithmonë njësoi
Froni i ëndërrimeve pakë herë lulëzon
Mysteri i asaj velloje ka një hije të rëndë gjithmonë.,

KULMI I DITURISË

Tërë botën e kam shëtiture
Rrethe e qark globit i kam rënë
Dija dhe shkenca janë bërë bujë
Triumfon fjalë dinjiteti si uji në lumë.,

Enigmat e së shkuarës ende janë këtu
Vonë shumë vonë Dinjiteti dhe Shkenca kanë përparua
Njerëzit, kafshët e lulet si fluska brumi kanë mbijetua ..

Sot bota e mbarë globi ka marrë shumë njohuri
E shkuara përkujtohet si një verbëri
Rrethe dijes tashmë merre frymë çdo njeri
Kulmi i diturisë ka zbriture mbi çati.,

Edhe shenjtorët e kanë marrë vrullin
Se dikur në veshë të shurdhëri patën mbeture
Sot me pakë fjalë miradije
Janë bërë super shenjtorë kryevepër.,

Më duket se një çmime vetëm koha po na e ndanë
Bota njohurin në një tepri po e shpërndanë
Në një termë kulminantë diturie njerëzimi çmendurisht
po bënë hatanë.,

Ç 'KËRKON TË GJESH

Çfarë do të kërkosh të gjesh
Më mirë gëzoje të sotmen
Lëri belat e kota në një anë
Mos u anko ti kot më kotë
Jeto e gëzuar në këtë botë ..

Vetëm për të marrët ka një lloji mërie
Ata nuk ja dinë vlerën asaj lumturie
Kurë ndihesh keq më kotë mos derdhë lotët
Jeto i buzëqeshure duaje këtë botë fortë ..

*** POEZI nga Sibela Bala *** POEZI nga Sibela Bala ***

Se jemi të huaj në shtegtim
Në fund të jetës kemi në udhë për në perëndim
S'do të pyetemi se si jetuam
Me gaz apo me lotët
Do shkojmë në atë tjetrën botë,,

Merri të mirat e kësaj bote si të mirëqena
Buzëqesh fole e gëzo
Për plagët e pashëruara mos u gjuhëzo
Se di çfarë kërkon të gjesh më shumë nga kjo botë
Jeto dhe vetëm jeto,,

DËFRIMET

Çfarë kam dashure kam bërë
Kam festuar kam heshture
Kam qeshur e kam bredhure
Kam ecure udhë e pa udhë
Kam dal në breg një lumi
E lodhure nga udha si një zogë shtegtarë,,

Po gjithmonë jam ndier esëll
Si një degë gonxheje në pragë të pranverës
Kurrë s' me ka zënë etje e të pastrehës
S'jam penduar kurrë për dëfrimet
që kam bërë gjatë jetës ,,

Kam hedhure papa që s' më kanë bërë ballë as mendimet
M' kanë dhënë rrëqethje edhe dëfrimet
Faqja kurrë s' më është n zi
Se kurrë si kam formatizuar gabimet,,

Besnike jam me vetveten time
Askujt si kam dhënë kurrë premtime
Se kam largu veten nga udha e zotit të plotfuqishëm
Kam bredhure e kam dëfryere anë e mbanë botës fur-
ishëm,,

MË THUAJI

Më thuaji ç' farë po ju trishtona më shumë
Pse po digjeni si skëterre në heshtje
Jeni bërë verdhë si gjethet kurë bien në vjeshtë,,

Më thuaji pse vallë jeni bërë verem
Në këngë e në valle më s'po i bëni ballë
Ku po shkoni kështu o ju të ngratë
Nuk mundeni të gëzoni dot -Altarë për Meshë dhe as për
Kungatë
Më thuaji vallë me ju çka ngjarë,,?

Jeni bërë si gërmadhë e vjetër
Të grisur të gjithë si një copëz letër
Më thuaji kush ju ka prishë foltoren e vjetër
Që s'po gjeni më mirëkuptim as me Ndërmjetës,,
Mos lakmoni me qasë në para të pa djersë
Më thuaji përse ju kurrë nuk latë në djersë
Kështu paraja kllapë nuk ju shkon
S'ka ardhmëri me një gjuhë intrige si ju
Më thuaji pse ju po luani të tillë lojë gjithmonë
Më thuaji sa nuk është vonë

Më thuaji kush ju infektoi në gjake
Këtë frymë lakmie jua mbolli në konakë
Mu thuaji deri kurë kështu o ju të ngratë
Mjaftë më mjaftë se mjaftë u hytë njerëzve të- pafajshëm
në hakë,,

MOS KËRKO MIQ

Asnjë herë mos zgjero rrethe shoqërore
Miq të tepërt mos dërgo në shtëpi
Mbjaj distancë nga njerëzit babëzi
Mos kërko miq o fatzi,,

Mos u bë si i marrë e sy- verbër
Kandilim mos e shkymë në mëri
Se shoqëria e miqtë e tepërt
Ti verbojnë sytë në pamshirësi
Mbjaj distancë nga arroganca o njeri,,

Mos i thuaj gjithkujt mik zemre
Se ata ta vjedhin çdo dritë shprese
Të lënë të verbër në vetmi
Miq të tepërt kurrë mos kërko
Se ata kurrë s'ta duan të mirën ty ,,

E ëmbël është fjala besnikëri
Të ligut kurrë mos i rri karshi
Mos kërko miq nëpër qytet
Mbjaj distancë se gjene pabesi
Kurrë mos kërko miq
Kurë se njehë asnjë njeri,,

Të vjetrit miq ruaj si sytë
Miqtë e ri të ta shtojnë neverinë
Ulu e analizo mirë me vetë dine
Hiqe dorë nga e kërkuara për miq të ri
Që për ty s'duan të ja dinë
Ruaje veten mos kërko miq
Me shkatrru veten me pabesin,,

SHTËPIA E VOGËL

Aty ku kam jetuar
Shtëpia ishte shumë e vogël
Sot është shndërruar në muze
Me mallëngjim e kam vizituar shpeshherë,,

Çdo gjë më kujtohet si atëherë
Që në dhomën e pritjes kishte plotë njerëz
E dhoma e gjumit ishte e zënë me shtretër
Të gjithë fëmijët flinin në një vende si të vegjël,,

Ajo dhoma e burrave e shtruam me qilim
Ata minderet e vjetër për rrethe asaj dhome të vogël
Miqtë kuvendonin
Mëzi e mbaj mënde se isha shumë e vogël,,

E sot më duket se po e shohë prapë
ketë shtëpi të vogël si dikur
Një pushkë druri e varure mbi mure
Një çajnik mbi zjarre duke valuare
E mbrëmjet e vonshme na gjenin
gjithmonë familjarisht të bashkuar ,,

Sot kjo shtëpi e dikurshme e vogël
Në muze është shndërruar
Gjithkush e ka vizituar
Edhe unë me një mall të pashuar
nuk ngopem duke e frekuentuar,,

Se këtu jam rriture
Kurrë ndjesinë e qetësinë e asaj shtëpie
Nuk mundem për ta harruar
Gjithmonë ndihem për atë shtëpinë

e vogël të dikurshme e përmalluar
Prandaj shpesh vij edhe unë për ta vizituar
E shpirtin nga malli për ta çliruar ,,


KOHA RRJEDHË

Koha rrjedhë sikur një burim uji
Të rinjtë e djeshëm kanë marrë vjetërsinë
Sot lindën brezat e rinjë
Kohërat lanë gjurmë
E fytyrat e gjithkujt u zburuan një kohë më kohën
E më vonë u plakën e bënë shkrimbe,,

Po në çdo kohë ka risi
Kohës jepi kohë që të falë risi
Nga brezi në brez të ketë përparësi
Të shkojnë moshat njerëzorë të gjitha radhazi
Me kohën në kohë të ecë çdo njeri
Të rinjtë e të vjetrit në përgjithësi,,

Koha rrjedhë si uji nëpër burime
Falë jetë hidhërimi e gëzime
Koha lë pas dhe jetimë
Lë pengë fjalë e premtime
Po koha së bashku me kohën në vazhdimësi
Jep atë që i përket jetës në risi
Nga brezi i vjetër fillon një risi
Ku koha lulëzon në çdo kohë me rini ,,

Koha rinisë i falë frymëzim,
trishtim e gëzim
Koha rinin e plakë
e i pagëzon radhazi
me fëmijë si prind
Mirë e dimë që udha
me kohën ka dhënë dëshmi
Koha rrjedhë si ujëvara
në burime gjithnjë për çdo brez moshash njerëzorë në
përgjithësi
Koha rrjedhë në kohë
nuk mbanë kurrë mëri ,,



REDAKSIA

Kryeredaktore: Klodjana Serraj
Luigj Shyti, Prele Milani, Lazer Kodra, Lazer Stani, Roza Pjetri,
Publicisti Zef Nika, Vuksan Kola, Zef Gjeta, Ledia Dushi, Leke Sokoli,
Edmond Tërthorja, Lulash Brigja, Vilson Peshkaj, Prele Shytani, Zef
Bari, Gjon Fierza, Ndue Ziçi, Gasper Marku, Mark Gjeka.

**MUNDËSOI BOTIMIN E GAZETËS
NR. 240, Z. NIKOLIN GJELOSHI
NGA FSHATI NENMAVRIQ, ME
BANIM NË FIRENZE TË ITALISË**

